									1269	ZANA		PRIFTI						
									1270	PRANVERA	KASEM	BEGAJ						
									1271	MIMOZA		SKENDERI						
									1272	ZELIHA		MUSI						
									1273	HAXHI		DEMIRI						
									1274	MEREME		DERVISHI						
									1275	FATMIR		DEMIRI						
									1276	FITNETE		NOVOSELA						
									1277	NEXHMIJE		DEDJA						
									1278	BUKURIJE		SHIJAKU						
									1279	SHEFQET		BEGA						
									1280	GEZIM		DURAKU						
									1281	QENDRESA		DURAKU						
									1282	NAZMIJE		CASILI						
									1283	MEREME		DERVISHI						
									1284	FIQIRETE		BEGA						
									1285	ERVIN		BEGA						
									1286	SHYQYRI		SKENDERI						
									1287	ISMAIL		SKENDERI						
									1288	LUMTURI		COKU						
									1289	AISHE		MUMAJESI						
									1290	FATBARDHA		KAZANI						
									1291	AFERDITA		SKENDERI						
									1292	ARDIAN		SKENDERI						
									1293	SOKOL		SKENDERI						
									1294	MERIBAN		DEMIRI						
									1295	ADRIANA		HASIBIA						
									1296	MEHMET		DEMIRI						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8350																		
225	ANDON	VANGJEL	DAKA	1233073	30.07.2020	TË VET+TË TRETËVE		132.7	1297	SHABAN	ABDURAHMAN	MEMA	251	1/636	132.7	66969	8886786.3	NË FAVOR TË ASMG SH.P.K. KUFIZOHET PASURIA, URDHËR REGJISTRUESI
									1298	GANI	ABDURAHMAN	MEMA						
									1299	METIJE	ABDURAHMAN	BEJLERI						
									1300	MUHAMET	ABDURAHMAN	MEMA						
									1301	RESHAT	ABDURAHMAN	MEMA						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8340																		
226	ARBEN	PREND	DEDA	89059	04.04.2013	TË TRETËVE		300	1301	AFITAP		KETA	252	1/1520	300	30158	9047400	NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË ME AFAT DERI NË ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË KRIJUAR NGA REGJISTRIMI I PARREGULLT NË SISTEMIN HIPOTEKAR; KRIJON MBIVENDOSJE ME PASURINË 1/919,1/920,1/918 DHE PASURINË 3/1
									1302	MAHMUDIE		JELLA						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8210																		
227	RASIM	ISLAM	BUCI	1232275	22.04.2020	SHTET + TË TRETËVE		36	1303	AGRON		TURDIU	253	1/588	6.15	38614	237476.1	
									1304	ARBEN		FAGU						
									1305	ARBEN		TURDIU						
									1306	ARIAN		TURDIU						
									1307	ARIOLA		TURDIU						

									1308	ARTUR		TURDIU						
									1309	BESNIK		KONCI						
									1310	DRITAN		KONCI						
									1311	EDMOND		FAGU						
									1312	ELDA		TURDIU						
									1313	ERMIRA		KODRA						
									1314	FATJONA		KONCI						
									1315	FATMIR		TURDIU						
									1316	FEJZI		KONCI						
									1317	GAZMEND		TURDIU						
									1318	GUGASH		BALENA						
									1319	HYSEN		BALENA						
									1320	MAJLINDA	ISMAIL	TABAKU						
									1321	GENCI	BESNIK	PUSTINA						
									1322	FATMIR	ISMAIL	TURDIU						
									1323	SUZANA	ISA	COBANI (PUSTINA)						
									1324	RAMAZAN	NEXHMI	KONCI						
									1325	MARGHERITA	GIRIBALDI	TURDIU						
									1326	REMZI	MUSTAFA	TURDIU						
									1327	PAQIZE	MUSTAFA	PETRELA						
									1328	HYSEN	ISMAIL	BALENA						
									1329	GUGASH	ISMAIL	BALENA						
									1330	FATJONA	QEMAL	GASHI						
									1331	BESNIK	QEMAL	KONCI						
									1332	ZAMIRA	QEMAL	MOLLA						
									1333	FEJZI	QEMAL	KONCI						
									1334	DRITAN	NEXHMI	KONCI						
									1335	SIBONEZ	NEXHMI	BILBILI						
									1336	LEJLA	ISMAIL	DEMNERI						
									1337	ZYDI	ALI	TURDIU						
									1338	SHPRESA	ALI	KAZAZI						
									1339	ERMIRA	ALI	KODRA	254	1/616	29.85	38614	1152627.9	
									1340	ARIAN	BILAL	TURDIU						
									1341	AGRON	BILAL	TURDIU						
									1342	ARBEN	BILAL	TURDIU						
									1343	PARID	QAZIM	TURDIU						
									1344	SILVA	QAZIM	TURDIU						
									1345	EDMOND	GALIP	MANSAKU						
									1346	ARTJANI	GALIP	MANSAKU						
									1347	MIRJANA	QAZIM	PUSTINA						
									1348	EDMOND	ADEM	FAGU						
									1349	ARBEN	BESIM	FAGU						
									1350	MUHARREM	HAXHI	DELIU						
									1351	ELDA	ISMAIL	COCOLI						
									1352	ARIOLA	ISMAIL	TURDIU						
									1353	GAZMEND	BESIM	TURDIU						
									1354	NERAIDA	BESIM	TURDIU						
									1355	ZENEPE	IBRAHIM	TURDIU						
									1356	MAHMUD	HASAN	TURDIU						
									1357	ARTUR	HASAN	TURDIU						
									1358	ILIRJAN	QEMAL	KONCI						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8320																		
									1359	HAZBI	SABRI	HAMITI						
									1360	RABIJE	SHAHIN	HAMITI						
228	FATMIR	PASHK	NDOJ	1232595	16.06.2020	SHTET+ TË TRETËVE		19.7	1361	VLADIMIR	XHEMAL	HAMITI	255	13/311	19.7	22985	452804.5	
									1362	ARBEN	SABRI	HAMITI						
									1363	NADIRE	SHAHIN	HAMITI						
									1364	SULLTANE	SABRI	HAMITI						

									1365	FATMIR	SHAHIN	HAMITI						
									1366	MANUSHAQE	QEMAL	HAMITI						
									1367	ALMA	QEMAL	SULAJ						
									1368	FLAMUR	QEMAL	HAMITI						
									1369	CLIRIM	AGIM	HAMITI						
									1370	ENKELEJDA	KASEM	ZYBERI						
									1371	GJYLE	SHAHIN	HAMITI						
									1372	NAFIJE	SHAHIN	HAMITI						
									1373	SERVETE		HAMITI						
									1374	MIMOZA	XHEMAL	HAMITI						
									1375	XHEVAHIRE	XHEMAL	HAMITI						
									1376	FLORESHA	XHEMAL	HAMITI						
									1377	ADELINA		HAMITI						
									1378	KLOTILDA	RAJMOND	HAMITI						
									1379	KLODJAN	RAIMOND	HAMITI						
									1380	HERKUL	FATOS	HAMITI						
									1381	FELLENXE	QEMAL	HAMITI						
									1382	ROLAND		HAMITI						
									1383	MYHYRIJE	SABRI	CORJA						
									1384	GANIMETE	SABRI	HAMITI						
									1385	DALLENDYSHE	SABRI	HAMITI						
									1386	RABIJE		HAMITI						
									1387	ADRIANA	SKENDER	IMERI						
									1388	LEONORA	SKENDER	FERO (HAMITI)						
									1389	FATION	SKENDER	HAMITI						
									1390	XHUME		HAMITI						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8310																		
229	KOZMA	MARK	MULLISI	38845	26.03.2013	TË TRETËVE		413.5	1391	FITNET	XHELO	TAMBURI	256	4/578	413.5	31219	12909056.5	
									1392	MIMOZA	SHEFQET	ISAJ						
									1393	FATOS	ZEQIR	SHEMSIU						
									1394	ROZANA	IRFAN	PUSTINA						
									1395	BUKURIE	IRFAN	SHKUPI						
									1396	EVA	PETRIT	GJELI						
									1397	MANJOLA	SELIM	GJELI						
									1398	LINDITA	SHEFQET	DASHI						
									1399	MIRVJENA	SELIM	GJELI						
									1400	ENIS	BAJRAM	GJELI						
									1401	ELMA	BAJRAM	MATI						
									1402	VJOLLCA	BEQIR	GJELI						
									1403	AGIM	IRFAN	PUSTINA						
									1404	REBEKA	IRFAN	DOLLANI						
									1405	SULEJMAN	ZEQIR	SHEMSIU						
									1406	GERT	PETRIT	GJELI						
									1407	ARJAN	QEMAL	GJELI						
									1408	XHELADIN	QEMAL	GJELI						
									1409	AIDA	QEMAL	KURANI						
									1410	FIQIRETE	HAXHI	GJELI						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8170																		
230	QEMAL	ISMAIL	TOLA	994411	18,09,2016	SHTET +TË TRETËVE		179.4	1411	LUAN	FAIK	ELBASANI	257	7/342	109.82	32878	3610661.96	
									1412	BUJAR	FAIK	ELBASANI						
									1413	HALIL	HAZIS	IBRO						
									1414	ANDI	HALIL	IBRO						
									1415	SANIJE	MUSA	TABAKU	258	7/339	69.58	32878	2287651.24	
									1416	MIRELA	FATMIR	DRAGONI(TABAKU)						
									1417	EPTAN	FATMIR	TABAKU						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8350																		
231	SHOQERIA "AL POINT"			1233050	30.07.2020	SHTET+TE VET+TË TRETËVE		265.6	1418	SUELA	HAXHI	NISHE (RADHESHI)	259	2/184	106.93	66969	7160995.17	
									1419	LAVDIJE	SHABAN	RADHESHI						

								1420	ELVIRA		RADHESHI						
								1421	MANJOLA		LIKA						
								1422	SHERIFE		RADHESHI						
								1423	SHPEND		LIKA						
								1424	ROVENA	GAZMEND	BARDHYLI						
								1425	ADRIANA		LIKA						
								1426	ALDO		LIKA						
								1427	BENIAMIN		LIKA						
								1428	ELVIRA		RADHESHI						
								1429	ENI		LIKA						
								1430	GLEDIS		LIKA						
								1431	HAXHI		RADHESHI	260	2/191	92.2	66969	6174541.8	
								1432	KEJSI		LIKA						
								1433	MANJOLA		LIKA						
								1434	NADIRE		RADHESHI						
								1435	SHERIFE		RADHESHI						
								1436	SHPEND		LIKA						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8110																	
								1437	ABDULLA	HAMIT	MYFTIU						
								1438	AFERDITA	RAMAZAN	BASHA						
								1439	AGIM	REXHEP	BASHA						
								1440	AHMET	HAMIT	MYFTIU						
								1441	AHMET	RAMAZAN	BASHA						
								1442	EMINE	REXHEP	BASHA						
								1443	ENGJELLUSHE		KOKONOZI						
								1444	EQEREM	HAJDAR	BASHA						
								1445	FITNETE	SHAQIR	BASHA						
								1446	GJYLE	SEFER	BASHA						
								1447	HAMIT		KOKONOZI						
								1448	HATIXHE	HAMIT	KRETANI						
								1449	ISMETE	HAMIT	MYRTERIZI						
232	HAJDAR	MALIQ	HIDA	122364	20.04.2018	TË TRETËVE		500.6	1450	LAVDIE		KOKONOZI	261	6/626	500.6	23703	11865721.8
									1451	LEJLA		KOKONOZI					
									1452	LUAN	RAMAZAN	BASHA					
									1453	LULJETA		KOKONOZI					
									1454	LULZIM	RAMAZAN	BASHA					
									1455	MIMOZA		KOKONOZI					
									1456	MUHAMET	HAJDAR	BASHA					
									1457	NAILE	RAMAZAN	BASHA					
									1458	QEMAL	HAJDAR	BASHA					
									1459	RIZA		BASHA					
									1460	SADIK	HAMIT	MYFTIU					
									1461	SHQIPE	ZYBER	BASHA					
									1462	SKENDER	REXHEP	BASHA					
									1463	YLBER		KOKONOZI					
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8310																	
233	XHAVIT RAMAZAN	ABAZ	XHEPA	1232272	22.04.2020	SHTET + TË TRETËVE		22	1464	SHOQERIA CENTER "SH.P.K" TIRANA TRADE			262	7/256	22	31219	686818	VENDOSET MASA E SEKUESTROS KONSERVATIVE ME URDHËR TË SHOQËRISË PËRMBARIMORE "STRATI BAILIFF'S SERVICE" SHPK, EDVIN MALOTAJ
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8310																	
								1465	ALMA	D	KOKOLI						
								1466	ARBEN		SINA						
								1467	BESIM		SINA						
234	PETRIT	HASAN	PERAJ	991712	07.10.2016	SHTET + TË TRETËVE		129.6	1468	BRIKENA	O	KOKOLI	263	6/155	129.6	31219	4045982.4	NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË ME AFAT DERI NË ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË KRIJUAR NGA REGJISTRIMI I PARREGULLT NË SISTEMIN HIPOTEKAR.
								1469	DURIM	O	KOKOLI						
								1470	FATMIRA	I	SHPATI						
								1471	HYSEN	D	KOKOLI						

									1472	KUJTIM	I	SHPATI						
									1473	LINDITA		SINA						
									1474	OSMAN	H	KOKOLI						
									1475	PETRIT	I	SHPATI						
									1476	QEFSERE	I	SHPATI						
									1477	SKENDER	I	SHPATI						
									1478	VJOLLCA	I	SHPATI						
									1479	ZHULJETA		SINA						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8190																		
235	HYSEN	MUSTAFA	SALIU	69885	22.05.2015	SHTET+ TË TRETËVE		39.2	1480	BAKUSHE		SEJDINI	264	8/312	39.2	33755	1,323,196.00	
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8360																		
236	ARBEN	REXHEP	SHULI	1230149	26.07.2018	SHTET+TË TRETËVE		63.9	1481	KADRI		RUBEJKA	265	3/82,	63.9	66,969	4,279,319.1	
									1482	MEHMET		RUBEJKA						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8120																		
237	VELI	BAJRAM	XHIKOLA	76997	06.02.2016	TË TRETËVE		328	1483	SIRI	TAHIR	BESHIRI	266	8/965,	328	29,106	9,546,768	
									1484	ESAT	TAHIR	BESHIRI						
									1485	LUTFIJE	TAHIR	DIZDARI						
									1486	NILMIJE	TAHIR	HAMZARAJ						
									1487	NJAZI	HYSEN	BESHIRI						
									1488	LIRI	JUSUF	KABA						
									1489	XHILDA	JUSUF	KOKA						
									1490	SAIR	JUSUF	PREZA						
									1491	NURI	ISUF	BESHIRI						
									1492	LEJLA		BESHIRI						
									1493	AIDA	ESHREF	GALANXHI						
									1494	MIRANDA	ESHREF	FERRA						
									1495	LINDITA	EJUP	NASHORVA						
									1496	SEMIRAMIZ	EJUP	KRAJKA						
									1497	AHMET	ISUF	RUSTEMAJ						
									1498	ARTEMONA	HAMET	RUSTEMAJ						
									1499	EDUARD	HAMET	RUSTEMAJ						
									1500	ANITA	HAMET	ROKO						
									1501	SELAUDIN	ABDYL	SHARRA						
									1502	ZANA	ABDYL	PUSTINA						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8210																		
238	ARBEN	SELAUDIN	GJONI	1233253	22.09.2020	SHTET+TË TRETËVE		17	1503	BUKURIJE	ABDULLA	BALLATI	267	7/517	17	38,614	656,438	
									1504	LUMTURI	ABDULLA	GEGA						
									1505	REMZI	ABDULLA	MARA						
									1506	VERA	ABDULLA	MARA						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8230																		
239	ERMIRA	OSMAN	XHAMETA	21654	15,07,2013	TE TRETËVE+SHTET		262	1507	ASLLAN	BILAL	XHAMETA	268	4/289	262	23,703	6,210,186	
									1508	GEZIM	SHERIF	XHAMETA						
									1509	HATIXHE		XHAMETA						
									1510	HAXHI	BILAL	XHAMETA						
									1511	QAMILE	SELMAN	XHAMETA						
									1512	SANIJE	BILAL	XHAMETA						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8340																		
240	SIMON	NDUE	NIKOLLI	994979	20.10.2016	TË TRETËVE		500	1513	AFITAP		KETA	269	1/1520	500	30,158	15,079,000	NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË ME AFAT DERI NË ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË KRIJUAR NGA REGJISTRIMI I PARREGULLT NË SISTEMIN HIPOTEKAR; KRIJON MBIVENDOSJE ME PASURITË 1/919,1/920,1/918,3/1
									1514	MAHMUDIE		JELLA						
241	EDUART	SIMON	NIKOLLI	1230321	21.08.2018	TË TRETËVE		499.9	1515	AFITAP		KETA	270	1/1520	499.9	30,158	15,075,984	NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË ME AFAT DERI NË ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË KRIJUAR NGA REGJISTRIMI I PARREGULLT NË SISTEMIN HIPOTEKAR; KRIJON MBIVENDOSJE ME PASURITË 1/919,1/920,1/918,3/1
									1516	MAHMUDIE		JELLA						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8120																		
242	LULJETA	QANI	HAMITI	98401	23.04.2015	TË TRETËVE			1517	BESIM	REFIK	KURTI	271	6/415	237.5	29,106	6,912,675	

									1518	DIANA	REFIK	OKETA						
									1519	BILAL	MUSA	KAIMI						
									1520	RASIM	MUSA	KAIMI						
									1521	ALI	MUSA	KAIMI						
									1522	SAMI	MUSA	KAIMI						
	GEJSI	ILIR	HAMITI						1523	SHABAN	IBRAHIM	VATHI						
									1524	LULJETA	IBRAHIM	VATHI						
									1525	FATIME	IBRAHIM	VATHI						
									1526	VJOLLCA	IBRAHIM	VATHI						
									1527	LUMTURI	IBRAHIM	VATHI						
	IRLA	ILIR	HAMITI						1528	AHMET	IBRAHIM	VATHI						
									1529	FADIL	IBRAHIM	VATHI						
									1530	DESHIRA	IBRAHIM	VATHI						
									1531	SHQIPONJA	IBRAHIM	VATHI						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8120																		
243	BEDRI	REXHEP	KASTRATI	72636	09.12.2015	PPV+TË TRETËVE		66.5	1532	BALLKIZE	RAMI	ASLLANI	272	10/514	66.5	29,106	1,935,549	
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8120																		
									1533	SEIDE	ISMAIL	DEMAJ	273	8/1077	44	29,106	1,280,664	
									1534	FATMIRA	HALIL	BAKIU						
									1535	VJOLLCA	BAJRAM	AZUNI	274	8/824	29	29,106	844,074	
									1536	ZOJE	BAJRAM	PUPA						
									1537	SEMIHA	BAJRAM	LACI						
244	NDOC	NDREC	NDOCI	1231361	06.05.2015	SHTET +TË TRETËVE		71	1538	ERVIN	KADRI	CIKU						
									1539	FATBARDHA	KADRI	RAMAJ						
									1540	ISMAIL	KADRI	CIKU						
									1541	FATMIRA	HAMDI	CIKU						
									1542	NIKEIDA	SALI	CIKU						
									1543	MIRA	BAJRAM	FJOLLA						
									1544	ZYRAFETE	SADIK	CIKU						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8130																		
245	KASTRIOT	FAHRI	MULLALLI	1230344	12,09,2018	SHTET+TË TRETËVE		199	1545	ISMAIL	HYSEN	XHURA	275	3/376	199	30196	6009004	PASURIA BLLOKOHET NGA DREJTORIA E TATIMEVE TIRANË
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8330																		
									1546	ASPASI		SHENKO						
246	REXHEP	MUHARREM	KIKA	70752	18.01.2016			189.4	1547	MERI		SHENKO	276	5/366	189.4	34068	6452479.2	
									1548	VISO		SHENKO						
									1549	ARBEN	XHEMAL	DONA						
	PJETER	NDUE	NDOJ						1550	HAXHI	XHEMAL	DONA						
247				1233757	25.11.2020	SHTET+TË TRETËVE		277	1551	HAXHIRE	HAXHI	DONA	277	9/ 822	277	34068	9436836	
									1552	IBRAHIM	HAXHI	DONA						
	ANGJELINA	PJETER	NDOJ						1553	MIRELA	XHEMAL	DONA						
									1554	QERIME	XHEMAL	DONA						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8130																		
248	RAKIP	RAMAZAN	NALLCIA	20601	02.09.2013	TË TRETËVE+SHTET		98.33	1555	ENVER	SELIM	HYSA	278	4/ 126	98.33	30196	2969172.68	KUFIZOHEN VEPRIMET: PRONA BLLOKOHET NGA DREJTORIA E TATIMEVE TIRANË. SHKRESA NR. ZVRPP 19114, DATË 28.5.2015

249	ARTUR	NAZMI	NALLCIA	1232602	16.06.2020	TË TRETËVE+SHTET		290.73	1556	ENVER	SELIMI	HYSA	279	4/ 126	163.17	30196	4927081.32	PRONA BLLOKOHET NGA TATIMET TIRANË. SHKRESA NR. ZVRPP 19114, DATË 28.5.2015
									1557	FATMIR	SELIMI	HYSA	280	4/ 125	59.53	30196	1797567.88	
									1558	FATMIRA	SELIMI	HYSA	281	4/ 124	68.03	30196	2054233.88	
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8340																		
250	GEG	NDUE	NIKOLLI	14233233	21,09,2020	SHTET+TË TRETËVE		392.5	1559	AFITAP		KETA	282	1/ 1520	392.5	30158	11,837,015	NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË ME AFAT DERI NË ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË KRIJUAR NGA REGJISTRIMI I PARREGULLT NË SISTEMIN HIPOTEKAR; KRIJON MBIVENDOSJE ME PASURITË 1/919,1/920,1/918,3/1
									1560	MAHMUDIE		JELLA						
BERAT																		
QARKU BERAT, ZONA KADASTRALE 8501																		
251	BRAHIM	HAXHI	XHAFA	10001938	04.10.2017	E të tretëve (366.7m²) Shtet (73.3m²)		440	1561	ARTAN	IRFAN	VETERIKU	283	18/4	366.7	4183	1533906.1	RIVLERËSUAR ME SHUMËN 2511054 LEKË, DATË 23.5.2013, REF. 09130
									1562	BRUNILDA	YMER	TRUNGU						
									1563	BURBUQE	YMER	KAFAZI						
									1564	DRITA	FAIK	KUKE						
									1565	FATBARDHA	YMER	GEGA						
									1566	FLORESHA	YMER	TAFA						
									1567	GJYLYSHANE	FAIK	MURDARASI						
									1568	IBRAHIM	YMER	BALA						
									1569	LUMTURI	YMER	HASA						
									1570	MELEQE	FAIK	MYRDERASI						
									1571	MIRELA	YMER	LEKA						
									1572	REXHINA	FAIK	PAROZI						
									1573	TOMOR	FAIK	MURDARASI						
									1574	VIOLETA	YMER	SOFIJA						
FIER																		
QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 1003																		
252	BAJRAM	QEMAL	SHPATA	209672	28.08.2020	TË TRETËVE			1575	FERDINANT	BAJRAM	BUZI	284	145/34	223.6	579	129464.4	
									1576	SILVANA	KRISTAQ	BUZI						

VENDIM
Nr. 1170, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT NË FUSHËN E MBROJTJES DHE TË SIGURISË[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20, pika 2, 21, pika 6, 23, pika 2, 26, pika 4, 31, pika 2, 47, pika 2, e 61, pika 3, të ligjit nr. 36/2020, "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen autoritetet kontraktore, të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 36/2020, "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", Agjencia e Prokurimit Publik dhe Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e rregullave të miratuara në këtë vendim.
3. Agjencia e Prokurimit Publik, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dhe të miratojë dokumentet standarde të tenderit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

[1] Ky vendim është përafruar pjesërisht me direktivën 2009/81/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, "Mbi koordinimin e procedurave për dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe që ndryshon direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE", të ndryshuar". Numri CELEX 32009L0081, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.216, datë 20.8.2009, faqe 76–136.

RREGULLAT
E PROKURIMIT NË FUSHËN E MBROJTJES DHE TË SIGURISË

KREU I
ORGANIZIMI I PROKURIMIT

Neni 1
Përgjegjësia e autoritetit kontraktor

Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimet me fonde publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 36/2020, "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë" (në vijim, LPFMS), të këtyre rregullave dhe udhëzimeve të dala në bazë dhe për zbatim të tyre.

Neni 2
Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit

1. Në përputhje me nenin 17 të LPFMS-së dhe me qëllim realizimin dhe përdorimin më të mirë të fondeve publike, Këshilli i Ministrave mund t'ia ngarkojë rolin e organit qendror blerës një autoriteti tjetër kontraktor për blerjen e mallrave, kryerjen e punëve ose të shërbimeve të njëjta, si dhe/ose lidhjen e marrëveshjes kuadër për punë, furnizime ose shërbime të caktuara, në emër dhe për llogari të institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe ministrave. Çdo autoritet tjetër kontraktor mund të kërkojë dhe, rrjedhimisht, të bjerë dakord me organin qendror blerës për kryerjen e prokurimit në emër të tij.
2. Nëse disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë të njëjtin mall, punë ose shërbim, ata mund të bien dakord t'i caktojnë njërit prej tyre rolin e organit qendror blerës për të prokuruar në emër të tyre. Ministritë ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të prokurojnë në mënyrë të përqendruar për autoritetet kontraktore të varësisë. Në këtë rast, ministrat ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të përdorin blerjen e përqendruar, duke nxjerrë udhëzimet e duhura për autoritetet kontraktore të varësisë.
3. Nëse një ose disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë mall/punë ose shërbim, ata mund të bien dakord të delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit një autoriteti

tjetër kontraktor, për shkak të kapaciteteve që ky i fundit ka në fushën e objektit të prokurimit.

Autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te njoftimi i shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e.

4. Prokurimi i përqendruar mund të përdoret kur:

a) blerja e përqendruar mundëson përfitime ekonomike, për shkak të rritjes së sasisë së mallrave, punëve ose shërbimeve homogjene dhe që ofrohen në treg me kushte të ngjashme;

b) autoriteti kontraktor, që luan rolin e organit qendror blerës, ka njohuri të mjaftueshme për artikujt që do të prokurohen.

5. Në bazë të një marrëveshjeje të shkruar ose të udhëzimeve administrative, organi qendror blerës kryen procedurën e prokurimit në emër të çdo autoriteti kontraktor, ndërsa ky i fundit përcakton specifikimet teknike, sasitë e punëve/mallrave/shërbimeve, që do të prokurohen, si dhe fondet përkatëse.

6. Organi qendror blerës shqyrton specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore. Nëse organi qendror blerës vlerëson se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me LPFMS-në ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre dhe njofton për këtë autoritetin kontraktor. Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën me ekspertë të fushës, të institucioneve përgjegjëse, si dhe me ekspertë të jashtëm, vendas ose të huaj, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet.

Nëse autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore kanë marrë për bazë çmime të ndryshme për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përllogarit të dhënat sasiore, sipas fondit përkatës.

7. Organi qendror blerës mund të kërkojë ndihmën e autoritetit kontraktor, si dhe duhet t'i sigurojë këtij të fundit, sa herë që e kërkon, akses të plotë në çdo informacion për procedurën e prokurimit.

8. Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurrimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese.

Neni 3
Publikimi i njoftimeve

Njoftimet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë publikohen njëkohësisht në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të secilit autoritet kontraktor që zhvillon procedura prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Në Buletin/faqen zyrtare, në përputhje me LPFMS-në dhe rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë publikohet:

a) njoftimi i kontratës;

b) njoftimi i fituesit, njoftimi i kontratës së lidhur dhe njoftimi i anulimit;

c) lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimet në fushën mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe arsyet e këtij përjashtimi, në përputhje me përcaktimet e nenit 13 të LPFMS-së;

ç) çdo informacion apo akt tjetër që gjykohet të nevojshëm për publikim në përputhje me LPFMS-n, ligje të tjera apo rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Neni 4
Publikimi i njoftimit të kontratës

Njoftimi i kontratës përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që i jep mundësi operatorëve ekonomikë të vendosin, nëse do të marrin pjesë ose jo në procedurat e prokurimit. Ky informacion përfshin: emrin dhe adresën e autoritetit kontraktor; adresën elektronike të autoritetit kontraktor; objektin; procedurën e prokurimit; vlerën limit të përllogaritur të kontratës dhe kohëzgjatjen e kontratës; një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet, nëse përdoren; kriteret për kualifikim dhe kriteret për uljen e numrit të kandidatëve (nëse aplikohet), kriteret e shpalljes së fituesit; kushtet e marrëveshjes kuadër; vendin, mënyrat dhe tarifën për tërheqjen e dokumenteve të tenderit, nëse kërkohet; vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre; gjuhën /gjuhët e ofertave dhe të

dokumenteve; informacione të mëtejshme të vlerësuara të dobishme nga autoriteti kontraktor.

Neni 5
Kufijtë monetarë

1. Në përputhje me nenin 20 të LPFMS-së, kufijtë monetarë janë:

a) kufiri për procedurat ndërkombëtare:

i. për kontratat e furnizimit dhe shërbimit me vlerë jo më të ulët se 50,964,400 lekë;

ii. për kontratat e punëve me vlerë jo më të ulët se 6,371,787 lekë.

b) kufiri për procedurat kombëtare:

për të gjitha llojet e kontratave me vlerë mbi 800 000 lekë deri në kufijtë e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1 të këtij neni.

2. Pavarësisht kufijve të mësipërm, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurat ndërkombëtare për plotësimin e nevojave të veta, në rast se ato nuk mund të ofrohen nga operatorët ekonomikë vendas, duke zbatuar përcaktimet për njoftimet, sipas këtij vendimi, referuar llojit të procedurës.

3. Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit të thjeshtuar, sipas parashikimeve në nenin 56 të këtyre rregullave.

Neni 6
Përllogaritja e vlerës së kontratës

1. Vlera limit e kontratës është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit. Në llogaritjen e vlerës merret parasysh edhe shuma totale që duhet paguar në rast ripërtëritjeje/rinovimit të kontratës, kur një rast i tillë është parashikuar. Kjo vlerë ka për qëllim klasifikimin e kontratës sipas kufijve monetarë. Vlera e TVSH-së llogaritet si zë më vete, por nuk përfshihet në vlerën limit të publikuar në njoftimin e kontratës. TVSH-ja, kur është e zbatueshme, i shtohet vlerës së ofertës fituese për llogaritjen e vlerës totale të kontratës që do të lidhet.

2. Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar.

Autoriteti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë aplikimin e kontratës shumëvjeçare dhe të bëjë një përllogaritje të saktë të fondit, ku të jepen hollësi për investimin që do të kryhet, amortizimin për çdo vit dhe përbërësit/elementet e tjera të ngjashme me to.

3. Në llogaritjen e vlerës limit të kontratës, në rastin e marrëveshjes kuadër, do të përfshihet vlera e të gjitha kontratave që mund të lidhen brenda afatit të kësaj marrëveshjeje.

4. Autoriteti kontraktor, në rastet e procedurave të prokurimit ndërkombëtare, mund të konvertojë vlerën limit të kontratës me një monedhë të huaj, të përzgjedhur prej tij, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën dërgohet për publikim njoftimi i kontratës.

5. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë: çmime zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale, etj.) dhe/ose:

a) çmimet e tregut;

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;

c) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

6. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të:

a) argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet;

b) marrë konfirmim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që fondet, të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime.

KREU II
DOKUMENTET E TENDERIT

Neni 7
Dokumentet standarde të tenderit

1. APP-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, përgatit formatin e dokumenteve standarde të tenderit, që do të përdoren gjatë

procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Këto dokumente japin informacion që ka lidhje me objektin e kontratës dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga autoritetet kontraktore. Dokumentet standarde të tenderit miratohen me vendim të drejtorit të Përgjithshëm të APP-së dhe publikohen në faqen e internetit të APP-së.

2. Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në këto rregulla prokurimi, dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike (nëpërmjet kërkesës dërguar nga operatori ekonomik në adresën elektronike të vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor ose nëpërmjet një kompakt disku, sipas kërkesës) ose kundrejt pagesës, në rastet kur vlerësohet nga autoriteti kontraktor.

Neni 8
Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit

1. Dokumentet standarde të tenderit për procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.

2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:

a) njoftimin e kontratës;
b) ftesën për ofertë;
c) deklaratën për ofertë të pavarur;
ç) udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
d) kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
dh) formularin për deklarimin e konfliktit të interesit;
e) formularin e informacionit konfidencial;
ë) deklaratën për zbatimin e kërkesave të legjislacionit të punës;
f) ofertën ekonomike;
g) sigurimin e ofertës;
gj) njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
h) formularin e ankesës;
i) njoftimin e fituesit;
j) kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës.
k) modelin e marrëveshjes kuadër;
l) sigurimin e kontratës;
ll) njoftimin e kontratës së lidhur;
m) njoftimin e anulimit të procedurës.

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:
i. projektin dhe specifikimet;
ii. preventivin e hollësishëm dhe kostot;
iii. grafikun e zbatimit;
iv. kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:
i. specifikimet teknike;
ii. grafikun e lëvrimit;
iii. kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:
i. termat e referencës;
ii. grafikun e ekzekutimit;
iii. kërkesat për personelin kryesor;
iv. kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

SEKSIONI I
INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Neni 9
Ftesa për ofertë

1. Ftesa për ofertë u dërgohet vetëm kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë të kualifikimit, përmes procedurës së prokurimit me faza, sipas parashikimeve të nenit 30 të LPFSM-së. Ajo përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u mundësojë kandidatëve të përzgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre.

Ky informacion përfshin, përveç të tjerash, edhe:

a) një referencë për njoftimin e kontratës;
b) një referencë për akses të dokumenteve të tenderit dhe të dokumenteve të tjera, të përcaktuara më sipër me rrugë elektronike, si p.sh: adresa elektronike, tek e cila kandidatët mund të dërgojnë kërkesën për marrjen e këtyre dokumenteve ose mundësia e dërgimit të dokumenteve nëpërmjet kompakt disqeve;

c) kriteret e shpalljes së fituesit;

ç) peshën dhe renditjen sipas përparësisë të kritereve të vendosura për përcaktimin e ofertës fituese, në rastin e ofertës ekonomikisht më të favorshme;

d) kushtet e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;

dh) afatin e fundit për pranimin e ofertave, adresën në të cilën duhet të dërgohen ofertat dhe gjuhën/gjuhët, në të cilat duhet të hartohet oferta;

e) gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;

ë) informacione të mëtejshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme.

2. Ftesës për ofertë i bashkëngjitet një kopje e dokumenteve të tenderit ose dokumente shpjeguese dhe çdo dokument tjetër mbështetës.

Neni 10

Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët

1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, si dhe veprimet që ndalohen me ligj. Në to shpjegohet se pjesëmarrësit në procedurën e prokurimit duhet të përdorin vetëm dokumentet standarde të tenderit për procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, pa bërë asnjë ndryshim.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit ndërkombëtare, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit kombëtare, gjuha e përdorur është gjuha shqipe.

3. Në udhëzime duhet të përcaktohet që, nëse autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në tender duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit. Gjithashtu, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga përfundimi i afatit për dorëzimin e ofertave, autoriteti kontraktor mund të organizojë një konferencë paraprake (edhe në rastin e mallrave), ku të gjithë kandidatët të mund të kërkojnë sqarime për paqartësitë që u lindin gjatë përgatitjes së dokumenteve.

Kërkesat për sqarime duhet të paraqiten me shkrim dhe përgjigjet përkatëse të autoritetit kontraktor duhet t'u dërgohen, pa përjashtim, të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë kërkuar dokumentet e tenderit.

4. Çdo ndryshim në dokumentet e tenderit duhet t'i bëhet i njohur çdo operatori ekonomik të interesuar, në përputhje me nenin 30 të LPFMS-së dhe me këto rregulla.

5. Gjatë përgatitjes së ofertave, kandidatët ose ofertuesit duhet të përfshijnë të gjitha detyrimet fiskale, që janë në fuqi deri në 28 (njëzet e tetë) ditë para hapjes së ofertave, me përjashtim të TVSH-së, e cila, nëse është e aplikueshme, do të llogaritet mbi vlerën e ofertës.

6. Ofertat ekonomike të dhëna nga ofertuesi duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi.

Nëse, pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm do të refuzohet nga autoriteti kontraktor si e papranueshme.

7. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 (pesë) ditë përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshmërinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë ofertuesit, me shkrim, të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton autoritetin kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor, lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë autoriteti kontraktor do të refuzojë ofertën.

Nëse procedura e prokurimit është e pezulluar, koha e pezullimit nuk llogaritet në periudhën e vlefshmërisë së ofertës.

Neni 11
Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes

1. Përmbushja e një ose disa kritereve të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 37 të LPFMS-së, mund të realizohet nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve të kërkuara dhe/ose vetëdeklarimeve me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit.

2. Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e kualifikimit/pjesëmarrjes, të cilat do të plotësohen me vetëdeklarim. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit.

3. Në rast se ka dyshime për vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.

Neni 12
Deklarimi i konfliktit të interesit dhe informacioni konfidencial

1. Ky deklarim garanton autoritetin kontraktor që ofertuesit/kandidatët nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Ai përmban të dhënat personale të ofertuesit/kandidatit dhe grupet e personave që konsiderohen si persona në konflikt interesi, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Nëpërmjet listës së informacionit konfidencial, kandidati/ofertuesi deklaron informacionin tregtar që kërkon të mbahet konfidencial.

Neni 13
Oferta ekonomike

Oferta ekonomike përmban vlerën e ofertës. Kësaj oferte i bashkëlidhet një listë e hollësishme çmimesh.

Neni 14
Sigurimi i ofertës

1. Sigurimi i ofertës, i cili kërkohet në çdo rast, shërben si masë mbrojtëse për autoritetin kontraktor, në rastet e ofertave të papërgjegjshme apo të tërheqjes së ofertave në mënyrë të njëanshme, pas hapjes së tyre apo refuzimit të nënshkrimit të kontratës.

2. Sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës së përllogaritur të kontratës (fond limit), të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

4. Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet:

a) të mos vendosë asnjë kusht për pagimin;

b) të paguajë shumën brenda 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës zyrtare të autoritetit kontraktor.

5. Autoriteti kontraktor duhet t'ua kthejë apo t'ua lirojë ofertuesve sigurimin e ofertës, jo më vonë se 15 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 15
Njoftimi i skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve

Ky njoftim përmban arsyet e skualifikimit të një ofertuesi apo kandidati në një procedurë prokurimi, në bazë të kërkesave të parashikuara në nenet 33 dhe 38 të LPFMS-së.

Neni 16
Njoftimi i fituesit

1. Njoftimi i fituesit duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e ofertuesit të shpallur fitues;

b) përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve;

c) kohëzgjatjen e kontratës dhe çmimin/vlerën e kontratës;

ç) emrat dhe çmimet/vlerën e ofertuesve të tjerë;

d) emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit;

dh) informacion, nëse ka pasur ankesa, si dhe

e) kërkesën që kontrata të nënshkruhet, me kusht që të jetë bërë sigurimi i saj.

2. Autoriteti kontraktor do të ftojë operatorin ekonomik të shpallur fitues që të lidhë kontratën, pas shqyrtimit të ankesave (nëse ka) dhe në çdo rast, pas përfundimit të afateve për ushtrimin e së

drejtës së ankimit, sipas përcaktimeve të nenit 54 të LPFMS-së. Operatori ekonomik i shpallur fitues është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

3. Njoftimi i fituesit për marrëveshjen kuadër duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e ofertuesit/ofertuesve të shpallur fitues;

b) përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve, si dhe kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër.

Neni 17
Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës përkufizojnë tërësinë e punëve që do të kryhen, të gjitha mallrat apo shërbimet që do të furnizohen, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kontraktorit, si dhe detyrimet për përmbushjen, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës, duke përfshirë edhe administrimin e informacionit të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 18
Sigurimi i kontratës

1. Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

2. Gjatë ekzekutimit, nëse janë parashikuar pagesa periodike, sipas grafikut të zbatimit të kontratës, kontraktori mund të kërkojë reduktimin e përqindjes së vlerës së sigurimit në mënyrë përpjesëtimore, por jo më pak se 25% të vlerës korrespondouese të sigurimit të kontratës.

3. Nëse ofertuesi i përzgjedhur nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, të përcaktuar në njoftimin e fituesit, atëherë autoriteti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës dhe lidh kontratën me ofertuesin e renditur të dytë në klasifikimin përfundimtar.

Neni 19
Njoftimi i kontratës së lidhur

1. Autoriteti kontraktor publikon njoftimin e kontratës së lidhur në të njëjtën mënyrë sikurse është publikuar njoftimi i kontratës, brenda 5 ditëve nga lidhja e kontratës.

2. Njoftimi duhet të përmbajë:

a) emrin e autoritetit kontraktor;

b) të dhënat për operatorin ekonomik të shpallur fitues;

c) përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve, çmimin dhe kohëzgjatjen e kontratës.

Neni 20
Njoftimi i anulimit

1. Autoriteti kontraktor publikon njoftimin e anulimit në të njëjtën mënyrë sikurse është publikuar njoftimi i kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të anulimit.

2. Njoftimi duhet të përmbajë:

a) objektin e procedurës dhe emrin e autoritetit kontraktor;

b) përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve;

c) arsyet e anulimit të procedurës, sipas përcaktimeve të nenit 36 të LPFMS-së.

SEKSIONI II
INFORMACIONE TË VEÇANTA PËR KONTRATAT

Neni 21
Kontratat për punë

1. Në dokumentet e tenderit për kontratat e punëve, projekti duhet të plotësohet me hollësi, duke dhënë çmimet për njësi, vëllimin dhe llojet e punëve.

2. Punët, sipas parashikimeve të LPFMS-së, mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projekt mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim, çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar. Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti kontraktor i

vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).

b) me kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

3. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

4. Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve.

5. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 37 të LPFMS-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

6. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime, ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

7. Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet ekonomike dhe financiare, autoriteti kontraktor mund të kërkojë:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, të paraqitura në autoritetet përkatëse;

b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, vlera e të cilave nuk mund të tejkalojë 50 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

8. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet, materialet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Neni 22
Kontratat e mallrave

1. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 18 të LPFMS-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

2. Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 37 të LPFMS-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë

zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

5. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor mund të kërkojë:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose

b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, vlera e të cilave nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

6. Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshmi e origjinalitetit të mostrave, përshkrimi dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Neni 23
Kontratat e shërbimeve

1. Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 37 të LPFMS-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

4. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, të paraqitura në autoritetet përkatëse;

b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, vlera e të cilave nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për

njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Neni 24
Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

Neni 25
Kërkesat e cilësisë

1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organizma të akredituar e të pavarur dhe dëshmi të sistemeve të ngjashme me certifikimet CE dhe NATO, si dhe dokumente për standarde të menaxhimit të mjedisit, sipas nenit 41 të LPFMS-së.

2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Neni 26
Kriteret për vlerësimin e ofertës

1. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët.

2. Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që, përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si: cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, cikli jetësor i produktit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet e tenderit.

Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike. Autoriteti kontraktor duhet të përgatisë një procesverbal për të pasqyruar procesin e vlerësimit të ofertave.

KREU III
LLOJET DHE PËRZGJEDHJA E PROCEDURËS

Neni 27
Llojet e procedurave të prokurimit

1. Në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe/ose të sigurisë, autoriteti kontraktor zbaton procedurat e prokurimit të përcaktuara në ligjin për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

2. Llojet e procedurave që duhen përdorur në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe/ose të sigurisë janë:

a) procedurë e kufizuar;

b) procedurë me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;

c) procedurë me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;

ç) dialogu konkurrues.

Neni 28

Procedura e kufizuar

1. Procedura e kufizuar, sipas nenit 25 të ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, është një procedurë prokurimi me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, në të cilën mund të kërkojë të marrë pjesë çdo operator ekonomik, fizik ose juridik, por të drejtën për të paraqitur një ofertë e kanë vetëm ata operatorë ekonomikë, të cilët përzgjidhen dhe ftohen për këtë qëllim nga autoriteti kontraktor.

Faza e parë (parakualifikimi) ka të bëjë me përzgjedhjen e kandidatëve përpara dërgimit të ftesës për ofertë nga AK-ja. Parakualifikimi i ofertuesve është një proces i ndryshëm nga procedura e vlerësimit të ofertave, e cila përqendrohet në çmimin dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Procesi i parakualifikimit do të bëhet duke u përqendruar në vlerësimin e përvojës dhe aftësinë e kandidatëve për të zbatuar në mënyrë të kënaqshme kontratën konkrete. Qëllimi kryesor i parakualifikimit është përzgjedhja e atyre kontraktorëve/furnitorëve, kualifikimet dhe përvoja e të cilëve minimizon rrezikun e mosekzekutimit, sipas projektit/kontratës së propozuar.

Në njoftimin e kontratës së publikuar do të përcaktohen edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve.

Autoriteti kontraktor fton jo më pak se 3 (tre) kandidatë, duke garantuar konkurrencë dhe barazi ndërmjet tyre, përveç rasteve kur numri i ofertuesve që kanë shprehur interes është më i ulët se minimumi i kërkuar.

Faza e dytë ka të bëjë me paraqitjen e ofertës dhe dokumenteve të kërkuara nga ofertuesit e kualifikuar në fazën I. Pas mbylljes së fazës së parakualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të njihen me dokumentet konkrete të tenderit dhe do të dorëzojnë ofertat sipas përcaktimeve në DT dhe të specifikimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë.

2. Autoriteti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me nenin 34 të LPFMS-së. Aplikimi i këtij kufizimi bëhet i ditur që në njoftimin e kontratës.

3. Pas mbylljes së fazës së parakualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat, në bazë të specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

4. Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe dorëzimin e ofertave për këtë procedurë janë sipas përcaktimeve të nenit 32 të LPFMS-së, në përputhje me kufijtë monetarë të detajuar në këto rregulla.

Neni 29

Procedura me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit

1. Procedura me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit është një procedurë prokurimi, e cila përdoret në ato raste kur autoriteti kontraktor negocion me ofertuesit, me qëllim përshtatjen e ofertave të tyre me kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës, me specifikimet dhe dokumentet mbështetëse, nëse ka të tilla, për të përzgjedhur ofertën më të mirë.

2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet njëkohësisht në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e internetit të AK-së, në përputhje me ligjin dhe me këto rregulla.

3. Afati kohor për pjesëmarrje në këtë procedurë, i parashikuar në nenin 32 të ligjit, është, si më poshtë vijon:

a) Në procedurën me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me vlerë më të lartë se kufiri monetar, afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje do të jetë jo më pak se 37 ditë kalendarike, nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës;

b) Në procedurën me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me vlerë më të ulët se kufiri monetar, afati kohor për pranimin e

kërkesave për pjesëmarrje do të jetë jo në pak se 25 ditë kalendarike nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës;

c) Kur njoftimet dhe dokumentet e tenderit janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, sipas parashikimeve në këtë vendim, afatet kohore të parashikuara në shkronjën "a" mund të shkurtohen me 7 (shtatë) ditë kalendarike dhe në shkronjën "b" mund të shkurtohen 5 (pesë) ditë.

4. Autoriteti kontraktor mund të marrë masa që procedura me negocim të kryhet në faza të ndryshme, duke zbatuar kriteret e vlerësimit, të shpallura në njoftimin e kontratës apo në specifikime, me qëllim reduktimin e numrit të ofertave që duhen negociuar. Njoftimi i kontratës apo dokumentet e kontratës tregojnë nëse ky opsion do të përdoret.

5. Autoriteti kontraktor mund të negociojë individualisht me secilin nga ofertuesit e përzgjedhur deri në përcaktimin e ofertës fituese. Në çdo rast, negocimi duhet të bëhet në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës.

Neni 30
Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

1. Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit, është një procedurë prokurimi, e cila përdoret në rastet e parashikuara në nenin 28 të LPFMS-së.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 44 të këtyre rregullave, duhet të paraqesë arsyet e përdorimit të kësaj procedure.

3. Me përjashtim të rrethanave të parashikuara në pikat 2, shkronja "b", 3, shkronja "b", dhe 4, të nenit 28, të ligjit, autoriteti kontraktor fton jo më pak se 3 (tre) kandidatë, duke garantuar konkurrencë dhe barazi ndërmjet tyre.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë.

4. Kur autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, duhet të provojë se kandidatët plotësojnë minimalisht kërkesat e nenit 37 të ligjit.

Në varësi të natyrës dhe përmasave të kontratës që prokurohet, autoriteti kontraktor përcakton kritere të veçanta për kualifikim, në lidhje me përzgjedhjen e ofertuesve.

Në rastin kur autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake, sipas parashikimeve të pikave 3, shkronja "a", dhe 4, shkronjat "a" dhe "b", të këtij neni, kur kontraktori i fundit është bashkim operatorësh ekonomikë, autoriteti kontraktor duhet të sigurohet që ky bashkim është i vlefshëm nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarimi nga anëtarët e këtij bashkimi.

5. Në rastin e procedurës së prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, afatet kohore parashikohen nga vetë autoriteti kontraktor, në varësi të objektit të prokurimit dhe rrethanave.

Neni 31
Dialogu konkurrues

1. Dialogu konkurrues është një procedurë prokurimi, e cila përdoret kur kontratat janë veçanërisht komplekse dhe kur autoritetet kontraktore mendojnë se përdorimi i procedurës së kufizuar apo procedurës me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës nuk mundësojnë prokurimin, ato mund të përdorin dialogun konkurrues dhe:

a) autoriteti kontraktor nuk është objektivisht i aftë të përcaktojë specifikimet/mjetet teknike për të kënaqur nevojat ose objektivat e tij; dhe/ose

b) nuk është objektivisht i aftë të specifikojë strukturën ligjore dhe/ose financiare të një projekti.

2. Autoriteti kontraktor duhet të justifikojë përdorimin e kësaj procedure.

Neni 32
Zvogëlimi i numrit të kandidatëve të përshtatshëm

1. Në rastin e procedurës së kufizuar, me negocim, me shpallje paraprake, dhe dialogut konkurrues, autoriteti kontraktor mund të përdorë opsionin e zvogëlimit të numrit të kandidatëve të përshtatshëm, për të cilët ajo do të paraqesë një ftesë për ofertë, për të negociuar ose për të marrë pjesë në dialog.

2. Në këtë rast, autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, duhet të tregojë kushtet ose rregullat që synon për të aplikuar në zvogëlimin e numrit të kandidatëve të përshtatshëm. Numri minimal i kandidatëve të përshtatshëm, që ka për qëllim të ftojë, nuk duhet të jetë më pak se 3.

3. Termat ose rregullat e përmendura në pikën 2, të këtij neni, duhet të jenë objektivë dhe jodiskriminues. Autoriteti kontraktor mund të përcaktojë kushtet ose rregullat në lidhje me vlerat relative, që u atribuohen atyre.

4. Në rast të numrit të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm, autoriteti kontraktor duhet të ftojë, të paktën, numrin e kandidatëve që është i barabartë me numrin minimal të paracaktuar të kandidatëve.

5. Në rast se numri i kandidatëve që plotësojnë nivelet minimale të aftësisë është më i vogël se numri minimal, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë me procedurën, duke ftuar një ose më shumë kandidatë që kanë aftësitë e kërkuara.

6. Kur autoriteti kontraktor merr parasysh se numri i kandidatëve të përshtatshëm është i pamjaftueshëm për të siguruar konkurrencë të vërtetë, ai mund të pezullojë procedurën dhe të botojë përsëri njoftimin fillestar të kontratës në fushën e mbrojtjes e të sigurisë dhe të vendosë afatin e ri për dorëzimin e kërkesës për të marrë pjesë. Në këtë rast, ata kandidatë, të cilët janë përzgjedhur në procedurën e pezulluar, si dhe ata të zgjedhur në vijim të njoftimit të dytë të kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, duhet të ftohen që të dorëzojnë ofertën për të negociuar ose për të marrë pjesë në dialog.

7. Në çdo rast, autoritetit kontraktor mund të anulojë procedurën e prokurimit publik, që është në proces, për të filluar një të ri.

8. Autoriteti kontraktor nuk duhet të ftojë operatorë ekonomikë shtesë, që nuk e kishin dorëzuar kërkesën për të marrë pjesë ose kandidatët, të cilët dështuan për të provuar përshtatshmërinë e tyre për fazën e dytë të procedurës së kufizuar, procedurën me negocim, me shpallje paraprake, dhe të dialogut konkurrues.

KREU IV
MARRËVESHJA KUADËR

Neni 33
Qëllimi

Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen dhe nuk ka siguri për kohën e dorëzimeve/realizimeve e të ekzekutimit të kontratave.

Kushtet e mallrave/shërbimeve/punëve, që do të prokurohen, nuk janë të përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Autoritetet kontraktore mund të blejnë vetëm për të plotësuar nevojat e tyre dhe jo për nevoja të autoriteteve kontraktore që nuk janë pjesë në marrëveshjen kuadër.

Neni 34
Palët në marrëveshjen kuadër

1. Një marrëveshje kuadër mund të lidhet ndërmjet:

a) disa autoriteteve kontraktore dhe disa operatorëve ekonomikë;

b) disa autoriteteve kontraktore dhe një operatori ekonomik;

c) një autoriteti kontraktor dhe disa operatorëve ekonomikë.

ç) një autoriteti kontraktor dhe një operatori ekonomik.

2. Autoritetet kontraktore që kanë për qëllim të lidhin një marrëveshje kuadër duhet të përcaktohen në njoftimin e kontratës. Nuk është e lejueshme të përdorin një marrëveshje kuadër autoritetet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër.

Të gjithë operatorët ekonomikë, që janë pjesë e marrëveshjes, duhet të listohen në marrëveshje dhe nuk është e lejueshme të pranohen operatorë ekonomikë të tjerë në marrëveshje, pas përfundimit të procesit të prokurimit.

Neni 35
Detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja kuadër

Një marrëveshje kuadër është ligjërisht e detyrueshme për të dyja palët. Autoritetet

kontraktore nuk janë të detyruara të prokurojnë një sasi të caktuar mallrash/shërbimesh/punësh të përfshira në marrëveshje. Por, në çdo rast gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, autoritetet kontraktore nuk lejohen të blejnë nga asnjë operator ekonomik tjetër të njëjtat mallra/shërbime/punë të mbuluara nga një marrëveshje kuadër, pasi kjo do të konsiderohej një shkelje e marrëveshjes.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të zbatojnë kontratën sipas cilësisë dhe çmimit të ofertuar, në kohën e kërkuar prej autoriteteve kontraktore.

Neni 36
Prokurimi i marrëveshjes kuadër

1. Marrëveshja kuadër prokurohet sipas këtyre rregullave. Ajo mund të lidhet vetëm pasi autoritetet kontraktore të kenë kryer një procedurë të kufizuar, me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ose dialog konkurrues.

2. Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër, duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 45 të LPFMS-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese, duke u bazuar në çmimin për njësi.

3. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në përputhje me LPFMS-në dhe këto rregulla.

Neni 37
Përllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër

1. Vlera e parashikuar e një marrëveshjeje kuadër duhet të përfshijë shumën e përllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

2. Në rastin kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër, duhet t'u referohet, për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përllogaritja e nevojave duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër.

Neni 38
Llojet e marrëveshjes kuadër

1. Marrëveshja kuadër mund të lidhet me:

a) një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara;

b) disa operatorë ekonomikë kur:

i. të gjitha kushtet janë të përcaktuara;

ii. jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

2. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të përgatitë ofertën e tij vetëm në lidhje me kushtet për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një kontratë bazuar në marrëveshjen kuadër në përputhje me LPFMS-në dhe këto rregulla.

3. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër, të lidhura me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re.

Në rast të përdorimit të kësaj lloj marrëveshjeje, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër.

Kjo lloj marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues.

Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë duhet të lidhen me të paktën tre operatorë ekonomikë, nëse të tre operatorët ekonomikë i kanë përmbushur të gjitha kriteret e përzgjedhjes. Në rast të kundërt, autoritetet kontraktore mund të lidhin marrëveshje kuadër me ato operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, me kusht që të jenë të paktën dy.

Në përfundim të afateve të ankimit, operatorët ekonomikë të kualifikuar në marrëveshjen kuadër renditen sipas kriterit të vlerësimit.

Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një kontratë, bazuar në marrëveshjen kuadër, në përputhje me LPFMS-në dhe këto rregulla.

4. Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, nuk konsiderohen kontrata.

Në rast të përdorimit të kësaj lloj marrëveshjeje, autoriteti kontraktor për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër duhet të rihapë konkurrimin.

Autoriteti kontraktor përgatit një ftesë për ofertë dhe ia dërgon vetëm operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, pa bërë njoftim publik. Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, kriteret e përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave.

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese gjatë rihapjes së konkurrimit mund të jenë të njëjta si ato të marrëveshjes kuadër ose autoriteti kontraktor mund të përdorë kritere të tjera, me kusht që ato të jenë të përcaktuara në dokumentet fillestare të marrëveshjes kuadër. Këto kritere mund të jenë çmimet për volume të caktuara, informacion për konsulencat për një shërbim intelektual, koha e nevojshme për dorëzim ose orët e nevojshme për kryerjen e punimeve specifike.

Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, për përzgjedhjen e fituesit për kontratat bëhet në formë të shkruar ose elektronike (e-mail, faks etj.) dhe, në çdo rast, duhet të dokumentohet e të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

Forma e komunikimit përzgjidhet nga autoriteti kontraktor, në varësi të kohës në dispozicion për përmbushjen e nevojës. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për të ruajtur konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave, deri në vlerësimin përfundimtar të tyre.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet t'u dërgojë, në të njëjtën kohë, ftesën për ofertë të gjithë operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër.

Autoriteti kontraktor harton e publikon njoftimin e fituesit për një kontratë bazuar në marrëveshjen kuadër në përputhje me LPFMS-në dhe këto rregulla.

Neni 39

Dhënia e kontratave sipas marrëveshjes kuadër

1. Kontratat mund të jepen mbi bazën e marrëveshjes kuadër përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së saj. Periudha e vlefshmërisë së kontratave të lidhura mbi bazën e një marrëveshjeje kuadër mund të kalojë periudhën e vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

2. Në rastin e marrëveshjes kuadër, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, gjatë rihapjes së konkurrimit, autoriteti kontraktor është i detyruar të krijojë një komision vlerësimi për dhënien e një kontrate në bazë të marrëveshjes kuadër.

Nuk është e nevojshme që përbërja e komisionit të jetë e njëjtë me atë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të përcaktuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrëveshjen kuadër.

3. Dhënia e kontratave në bazë të një marrëveshjeje kuadër të realizuar nga një autoritet kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës do të bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese.

i. Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet kontraktor, njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

ii. Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës, njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike nga autoriteti kontraktor, në cilësinë e organit qendror blerës.

4. Sasitë e parashikuara janë vetëm "sasi orientuese". Autoriteti kontraktor mund të blejë më pak ose më shumë se sasitë e parashikuara (por, në çdo rast, brenda vlerës së përllogaritur të marrëveshjes kuadër).

5. Operatori ekonomik, që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të formojë një bashkim operatorësh ekonomikë dhe të paraqesë ofertë për një kontratë, pasi është bërë palë e kësaj marrëveshjeje kuadër.

6. Operatori ekonomik, që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të caktohet si nënkontraktor i një operatori ekonomik tjetër, që i është dhënë kontrata sipas së njëjtës marrëveshje kuadër.

7. Nëse një operator ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër, nuk përmbush më kriteret e kualifikimit, për të cilat është shpallur fitues në këtë marrëveshje, është i detyruar të njoftojë autoritetin kontraktor menjëherë, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i ndodhjes së një ndryshimi të tillë.

Neni 40
Ndryshimi në numër i palëve të marrëveshjes kuadër

Nëse para mbarimit të marrëveshjes kuadër, të nënshkruar me disa operatorë ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, mbetet vetëm një operator ekonomik, autoriteti kontraktor nuk duhet të japë kontrata sipas kësaj marrëveshjeje kuadër.

Kur lind një situatë e tillë, autoriteti kontraktor është i detyruar të njoftojë menjëherë operatorin ekonomik të mbetur në marrëveshjen kuadër. Vlefshmëria dhe efektiviteti i marrëveshjes kuadër pushojnë së ekzistuari me këtë njoftim.

Në rast se një operator ekonomik nuk i përgjigjet dy herë radhazi ftesës së autoritetit kontraktor gjatë rihapjes së konkurrimit, ky operator nuk do të jetë më palë e marrëveshjes kuadër.

KREU V
ZYRTARËT E PROKURIMIT DHE ZHVILLIMI I PROCEDURAVE

Neni 41
Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar

Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrit të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPFMS-në dhe me këto rregulla.

Neni 42
Njësia e prokurimit

1. Për çdo procedurë prokurimi, njësia e prokurimit caktohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është specialist fushe. Njësia e prokurimit duhet të administrojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit.

Në rast mungese personeli, autoriteti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.

Përveç sa më sipër, autoriteti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete kontraktore.

2. Njësia e prokurimit kryen detyrat e mëposhtme:

a) sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion;

b) përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin, kur është rasti), kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;

c) hartimin e urdhrit të prokurimit;

ç) përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;

d) hartimin dhe dërgimin e njoftimeve, brenda afateve kohore;

dh) hartimin dhe dërgimin e ftesave për pjesëmarrje kandidatëve të ftuar në një procedurë prokurimi;

e) administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

ë) llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti;

f) administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor.

3. Specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, kryen detyrat e mëposhtme:

a) hartimin e specifikimeve teknike, në rast se nuk janë hartuar nga struktura të tjera;

b) përllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

c) hartimin e kritereve të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik;

ç) hartimin e kritereve të vlerësimit, nëse është rasti;

d) përcaktimin e çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh.: grafiku i livrimit).

Neni 43
Komisioni i vlerësimit të ofertave

Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Komisioni është përgjegjës për përzgjedhjen e kandidatëve, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.

Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

Neni 44
Urdhri i prokurimit

Pas përllogaritjes së fondit limit, sipas nenit 6 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

a) objektin e prokurimit;

b) fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;

c) llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);

ç) emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

Neni 45
Hartimi i dokumenteve të tenderit

1. Dokumentet e tenderit hartohen nga Njësia e Prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, Njësia e Prokurimit shfrytëzon dokumentet standarde të tenderit duke bërë modifikimet e nevojshme, në mbështetje të kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen

nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion njësisë së prokurimit, e cila e bën pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

3. Autoriteti kontraktor duhet t'i japë çdo operatori ekonomik të interesuar, kundrejt kërkesës, një kopje të dokumenteve të tenderit në përputhje me këto rregulla.

Neni 46
Ndryshimi i dokumenteve të tenderit

1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës jo më pak se 5 (pesë) ditë për prokurimet kombëtare dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ditë për prokurimet ndërkombëtare, në përputhje me nenin 20 të LPFMS-së.

2. Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, nëpërmjet hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që janë njohur me dokumentet e tenderit, dhe bëhet detyruese për ta.

Neni 47
Dorëzimi i ofertave

1. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit brenda afatit kohor të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e tyre. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit kontraktor nuk shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe i kthehet e pahapur kandidatit/ofertuesit.

Përveç sa më sipër, operatorët ekonomikë mund të jenë të pranishëm, nëse e kërkojnë, në procesin e hapjes së ofertave.

2. Në fazën e parë të kualifikimit, zarfi duhet të përmbajë vetëm dokumentet e kualifikimit, siç parashikohet në njoftimin e kontratës. Në fazën e dytë e në vijim, operatori ekonomik duhet të dorëzojë zarfin me çdo dokumentacion tjetër të kërkuar për këtë fazë (nëse është rasti), ofertën teknike dhe zarfin me ofertën ekonomike.

3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative.

Neni 48
Hapja e ofertave

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave hap dhe lexon ofertat, në përputhje me nenin 43 të LPFMS-së dhe me përcaktimet në këto rregulla.

2. Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.

Nëse evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose me disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohej përpara këtij momenti, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i prokurimit.

3. Anëtarët e njësisë së prokurimit, që kanë marrë pjesë në hartimin e dokumenteve të tenderit, mund të jenë të pranishëm gjatë fazës së hapjes dhe të vlerësimit, por nuk kanë të drejtë të votojnë ose të ndikojnë në procesin e shqyrtimit. Ata mund të japim mendime vetëm kur u kërkohet, si dhe të kryejnë funksione të karakterit ndihmës, si mbajtja e procesverbalit, sistemimi dhe ruajtja e dokumenteve.

4. Komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e ofertuesit dhe hap zarfin përkatës. Më pas lexohet me zë të lartë oferta ekonomike dhe lista e dokumenteve ligjore, administrative dhe kualifikuese të paraqitura nga ofertuesi. Procesverbali dhe një vërtetim, që pasqyron të gjitha dokumentet, që shoqërojnë ofertën e tij duhet t'i vihet në dispozicion në bazë të kërkesës çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesve që kanë paraqitur ofertë, por që nuk janë të pranishëm ose të përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'u dërgohet njoftim për hapjen e procedurës.

Oferta ekonomike nënshkruhet në pjesën e pasme të fletës nga të gjithë anëtarët e komisionit.

5. Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla.

Neni 49
Ndërhyrja në ofertë

Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën procedurë prokurimi. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

Neni 50
Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

1. Pas hapjes dhe leximit të ofertës, siç përcaktohet më lart, komisioni i vlerësimit të ofertave vë në dijeni përfaqësuesit për orën dhe datën kur ofertuesve do t'u komunikohet rezultati i vlerësimit të ofertës, që përfshin atë teknike, nëse ka të tillë, ekonomike, si dhe klasifikimin përfundimtar.

2. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 10 (dhjetë) ditë për fazën e parakualifikimit dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, për fazën e dytë të vlerësimit të ofertës teknike-ekonomike, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla.

Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.

3. Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

4. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

b) nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.

5. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

a) në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 46 të LPFMS-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur;

b) në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 46 të LPFMS -së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 46 të LPFMS-së.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e

veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 44 të LPFMS-së.

6. Në fazën e parë, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin e adresën e kandidatit dhe listën e të gjitha dokumenteve të kualifikimit, të paraqitura prej tij. Komisioni i vlerësimit të ofertave përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, që do të vlerësohen për t'u ftuar në fazën e dytë. Kandidatëve të kualifikuar, në përfundim të afateve të ankimit, u dërgohet një ftesë për ofertë, në përputhje me nenin 30 të LPFMS -së.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vazhdon vlerësimin e ofertave të fazës së dytë, të cilat përfshijnë dokumentet për plotësimin e kritereve të kualifikimit të fazës së dytë dhe/ose ofertën teknike. Komisioni i vlerësimit të ofertave kalon në shqyrtimin e ofertës ekonomike dhe verifikon nëse ka gabime aritmetike apo çmim anomalisht të ulët, sipas përcaktimeve në pikat 4 dhe 5, të këtij neni.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal. Në bazë të ofertave të pranuara, komisioni i vlerësimit të ofertave harton renditjen përfundimtare.

7. Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.

8. Në bazë të ofertave të pranuara dhe të renditura sipas kritereve të vlerësimit, komisioni i vlerësimit të ofertave bën klasifikimin e ofertave, sipas pikës 6, të nenit 31 të LPFMS-së.

Neni 51
Hartimi dhe publikimi i njoftimit të fituesit

Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit njëkohësisht në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe faqen e internetit të autoritetit në përputhje me nenin 16 të këtyre rregullave.

Neni 52
Raporti përmbledhës

Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të periudhës së pritjes për të drejtën e ankimit ose përfundimit të shqyrtimit të ankesës/ankesave, përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor.

Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/ mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve/ hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; procesin e hedhjes së shortit (nëse ka pasur); ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër apo korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave.

Neni 53
Lidhja e kontratës

1. Në përfundim të procedurës së prokurimit, sipas përcaktimeve në këto rregulla, autoriteti kontraktor lidh kontratën me ofertuesin fitues, në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 16, të këtyre rregullave.

2. Në çdo rast, kontrata do të lidhet vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor.

Neni 54
Publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar

Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti kontraktor dërgon njëkohësisht për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e internetit të AK-së njoftimin e kontratës së nënshkruar.

Neni 55
Rregullat për komunikimet elektronike

1. Pa cenuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik, si më poshtë vijon:

a) informacionet, që lidhen me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, janë në dispozicion të palëve të interesuara. Mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në LPFMS dhe me legjislacionin përkatës;

b) ofertat elektronike duhet të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për nënshkrimin elektronik, dokumentin elektronik, si dhe për bazat e të dhënave shtetërore;

c) përpara përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar për dorëzimin e ofertave ose të kërkesave për pjesëmarrje, ofertuesit marrin përsipër të paraqesin dokumentet, certifikatat dhe dëshmitë, të përmendura në nenet 37 e 38 të LPFMS-së, nëse këto të fundit nuk ekzistojnë në format elektronik.

2. Pa paragjykuar parimin e mosdiskriminimit, rregullat e mëposhtme zbatohen për nënshkrimin në formë elektronike për gjithçka që ka të bëjë me paraqitjen dhe pranimin e ofertave dhe dokumenteve të lidhura me to:

a) kur LPFMS-ja parashikon nënshkrimin nga ana e një personi, kjo kërkesë quhet e përmbushur për të gjitha dokumentet e tenderit, nëse nënshkrimi elektronik i përdorur është i besueshëm dhe i përshtatshëm për qëllime, për të cilat dokumenti elektronik është krijuar ose është komunikuar, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat konkrete ose në përputhje me ligjet dhe rregullat me aplikim të përgjithshëm për tregtinë në formë elektronike;

b) nënshkrimi në formë elektronike do të konsiderohet i besueshëm dhe në përputhje me këtë ligj, nëse:

i. nënshkrimi është i dukshëm dhe brenda materialit për të cilin prezantohet, i lidhur logjikisht me personin që firmos dhe jo me ndonjë person tjetër;

ii. dokumentet origjinale ose të dhënat e përdorura për nënshkrimin në mënyrë elektronike në momentin e firmosjes kanë qenë nën kontrollin ekskluziv të personit që nënshkruan dhe mbeten të tilla gjatë procesit të prokurimeve dhe për një kohë të arsyeshme pas përfundimit të procesit të prokurimit dhe siç parashikohet nga LPFMS-ja;

iii. çdo ndryshim në nënshkrimin elektronik, i bërë pas kohës së firmosjes, mund të dallohet me një kujdes të arsyeshëm;

iv. asnjë nga parashikimet në këtë nen nuk ka për qëllim të kufizojë mundësinë e çdo personi ose operatori ekonomik që, në çdo mënyrë të lejuar nga legjislacioni në fuqi, të provojë apo të kundërshtojë besueshmërinë e nënshkrimit elektronik.

Neni 56
Procedura e thjeshtuar e prokurimit

1. Autoriteti kontraktor përdor procedurën e thjeshtuar të prokurimit për punë/mallra/shërbim objekt i LPFMS-së, kur vlera e përllogaritur e tyre është më e ulët se 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vit. Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

2. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar.

3. Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre. Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me parashikimet e këtyre rregullave, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. Urdhri i prokurimit duhet të shoqërohet me ftesën për ofertë, që u drejtohet operatorëve ekonomikë, në të cilën përcaktohen të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit.

4. Në çdo rast, anëtarët e komisionit ftojnë të paktën 3 (tre) operatorë ekonomikë, kur është e

mundur, si dhe publikojnë ftesën për ofertë për çdo të interesuar njëkohësisht në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe faqen e internetit të autoritetit. Në çdo rast, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet autoritetit kontraktor, brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë. Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të fundit. Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit të thjeshtuar nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim. Afati i fundit për pranimin dhe hapjen e ofertave nuk duhet të jetë ditë pushimi (e shtunë, e diel, festa zyrtare). Për procedurat e thjeshtuara të prokurimit nuk zbatohen përcaktimet për ofertat anomalisht të ulëta dhe përcaktimet për ankimin administrativ.

5. Në asnjë rast, procedura e thjeshtuar e prokurimit nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.

KREU VI
KUSHTE TË PËRGJITHSHME PËR ZBATIM

Neni 57
Mungesa e konkurrencës

1. Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi, duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme. Në të kundërt, autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit.

2. Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim nga njësia e prokurimit.

Neni 58
Bashkimi i operatorëve ekonomikë

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 37 të LPFMS-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

3. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 6, të nenit 21, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

4. Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet.

5. Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

Neni 59
Nënkontraktimi

1. Autoriteti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës. Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t'ua transferojnë kontratën palëve të treta. Autoriteti kontraktor lejon në veçanti nënkontraktimin për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël e të mesëm ekonomikë.

2. Në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë, nëse lejohet ose jo nënkontraktimi.

3. Në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 30 (tridhjetë) % të vlerës së kontratës.

4. Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë punët/shërbimet/mallrat ose një pjesë të tyre që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues, si dhe emrin e nënkontraktorit.

5. Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori plotëson kërkesat e nenit 37 të LPFMS-së, si dhe zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë.

6. Ofertuesi fitues do të veprojë në mënyrë transparente dhe do të trajtojë nënkontraktorët në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese.

7. Në rast të mosplotësimit nga nënkontraktori të kritereve të kërkuara, autoriteti kontraktor vijon me lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik të shpallur fitues.

8. Gjatë ekzekutimit të kontratës autoriteti kontraktor duhet të kontrollojë nëse pjesa e kontratës, e marrë përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori, po realizohet nga ky i fundit. Në rast se autoriteti kontraktor konstaton se nënkontraktori nuk po realizon pjesën e kontratës së marrë përsipër, i kërkon kontraktorit kryesor të ndërpresë nënkontraktimin dhe të vijojë me zbatimin e kontratës.

KREU VII
KOHËZGJATJA DHE MBIKËQYRJA E KONTRATËS

Neni 60
Kohëzgjatja e kontratës

1. Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit buxhetor, përveç rasteve kur lidhen kontrata që kërkojnë financim nga fonde të më shumë se një viti buxhetor. Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

2. Autoriteti kontraktor nuk lidh kontrata që kërkojnë financim nga fonde të më shumë se një viti buxhetor për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht.

3. Vetëm në rrethana të argumentuara, të shpallura në njoftimin e kontratës, që lidhen ngushtësisht me natyrën, kompleksitetin dhe financimin e saj, autoriteti kontraktor mund të lidhë një kontratë kërkon financim nga fonde të më shumë se një viti buxhetor, sipas përcaktimeve në këto rregulla.

4. Autoritetet kontraktore, për plotësimin e nevojave me mallra dhe shërbime të vazhdueshme, lejohen të zgjasin afatin e kontratës, nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate shtesë me të njëjtin kontraktues, deri sa të kryhen procedurat e prokurimit. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë në mënyrë të detajuar nevojën për zgjatjen e kontratës.

5. Kontrata shtesë për mallrat apo shërbimet e vazhdueshme duhet të nënshkruhet brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i kontratës fillestare me një vlerë maksimumi 20% të kontratës së fundit. Fondet për kontratën shtesë do të përballohen nga fondet e vëna në dispozicion të autoritetit kontraktor në buxhetin e atij viti.

Neni 61
Mbikëqyrja e kontratës

1. Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

2. Pas vendimit për përjashtimin, autoriteti kontraktor njofton APP-në për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurime, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e vendimit.

3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të mbikëqyrë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në

kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

4. Autoriteti kontraktor merr informacion në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të kontratës nga struktura/sektori i ngritur pranë autoritetit kontraktor për këtë qëllim.

KREU VIII
SHQYRTIMI I ANKESAVE

Neni 62
Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave

1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, mund ta kundërshtojë këtë vendim.

2. Ankesa, si për dokumentet e procedurës, ashtu edhe për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar paraqitet me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik, sipas formularit përkatës, ku shënohen emri, adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe baza ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat ai mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

3. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet, detyrimisht, për dijeni, edhe autoritetit kontraktor. Me marrjen e dijenisë në lidhje me ankesën e paraqitur, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.

4. Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

5. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga dita e nesërme e marrjes dijeni të njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

6. Afatet e parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, shkurtohen me 5 (pesë) ditë në rastet e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike.

7. Me marrjen e ankesës me shkrim të ankuesit, Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim lidhur me përmbushjen e elementeve formale të ankimit, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës. Brenda 5 (pesë) ditëve nga vendimi për plotësimin e elementeve formale, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkon informacion apo dokumentacion autoritetit kontraktor. Ky i fundit ka detyrimin t'i përgjigjet kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e saj.

Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim jo më vonë se 20 (njëzet) ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar.

Përjashtimisht, nëse Komisioni i Prokurimit Publik, për shkaqe të ligjshme, nuk arrin të marrë një vendim brenda afatit 20-ditor, ai duhet t'u bëjë të ditur palëve në proces arsyet e mosmarrjes së këtij vendimi. Nga ky moment, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të dalë me vendimin përfundimtar për shqyrtimin e ankesës.

8. Procedura e rishikimit administrativ dhe vendimmarrja e Komisionit të Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, bëhen në përputhje me parashikimet përkatëse në këtë vendim, në LPFSM dhe legjislacionin përkatës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

9. Në çdo rast, gjatë procedurës së rishikimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik duhet të mbajë në konsideratë detyrimet ligjore për trajtimin e informacionit të klasifikuar.

10. Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, palët në proces dhe personat e interesuar kanë të drejtë të ankohen në gjykatën përkatëse, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat konkurruese, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

11. Çdo ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet kundrejt pagesës.

Neni 63
Sanksionet administrative

1. Në përfundim të procedurës së hetimit administrativ të kryer nga APP-ja, sipas kompetencave të përcaktuara në nenin 14 të LPFMS-së, vendosen masa për kundërvajtjet administrative, sipas parashikimeve të nenit 61 të LPFMS-së.

2. Në dhënien e masës administrative duhet të mbahen parasysh rrethanat, pasoja dhe roli i zyrtarit në shkelje dhe, në çdo rast, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 64
Dispozita tranzitore

Procedurat e prokurimit të filluara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi të vazhdojnë sipas rregullave të prokurimit publik, në bazë të të cilave ato kanë filluar.

VENDIM
Nr. 1172, datë 24.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 171, DATË 27.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'PËR KUSHTET DHE KRITERET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË STACIONIT TË PLAZHIT'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nenin 14 të rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", që i bashkëlidhet vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, fjalët "... për vitin 2020 ..." zëvendësohen me "... për vitin 2021 ...".

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Afati i sezonit turistik do të jetë nga data 1 maj deri më 15 nëntor.".

3. Në fund të pikës 3 shtohen fjalët "... dhe asistohet nga Task-Forca Ndërinstitucionale e Sezonit Turistik, e ngritur me urdhër të Kryeministrit.".

4. Pikat 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"4. Detyrat e Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik janë:

a) miratimi i listës së plazheve dhe i hartës së stacioneve të plazheve, sipas tipologjive të tyre, si dhe plazheve publike, bazuar në propozimet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat pajisen me një numër të veçantë identifikues, që publikohet në momentin e hapjes së aplikimit *online*;

b) monitorimi i mbarëvajtjes së sezonit turistik, si dhe koordinimi ndërinstitucional për respektimin e masave dhe të detyrimeve të çdo institucioni përgjegjës sipas detyrave funksionale respektive.

5. Si autoritet i shqyrtimit të aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi ngrihet grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve (në vijim "GTSHA"). Ngritja dhe mënyra e funksionimit të GTSHA-së miratohen me urdhër ministri.".

5. Në pikën 6, fjalët "... dhe e grupit teknik të shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA) ..." hiqen.

6. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) në shkronjën "c", fjala "... para ..." zëvendësohet me "... pranë ...";

b) pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) Në mungesë të strukturave akomoduese apo të strukturave të shërbimit si më sipër, subjekti mund të aplikojë për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 9, të vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar, njëkohësisht me kërkesën për menaxhimin e stacionit të plazhit, sipas përcaktimeve, të cilat do të parashikohen me urdhër të ministrit përgjegjës të turizmit. Sipërfaqja e lejuar e strukturës së shërbimit mund të jetë deri në 10 (dhjetë) % të të gjithë sipërfaqes së miratuar të stacionit të plazhit, por, në çdo rast, nuk mund të tejkalojë sipërfaqen totale prej 60 (gjashtëdhjetë) m^2.".

7. Pikat 8, 9 dhe 10 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"8. Kërkesa për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi dhe të strukturës së shërbimit, sipas rastit, bëhet direkt nga subjekti i interesuar nëpërmjet portalit *e-Albania*, sipas njoftimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Ministria mund të hapë më shumë se 1 (një) thirrje për aplikim brenda një sezoni turistik.

9. Dokumentacioni paraprak i nevojshëm për procesin e aplikimit *online* është, si më poshtë vijon:

a) formulari i kërkesës *online*, sipas numrit përkatës identifikues të stacionit të plazhit. Për çdo stacion plazhi bëhet nga një aplikim i veçantë;

b) plani i operimit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi dhe strukturë shërbimi, sipas rastit, sipas formatit të publikuar *online*;

c) foto të jashtme të qarta të strukturës akomoduese/së shërbimit, të cilat të identifikojnë strukturën akomoduese/e shërbimit në raport me hapësirën e plazhit, si dhe foto të qarta të hapësirës së plazhit për të cilën aplikohet.

10. GTSHA-ja, për shqyrtimin e kërkesave, ndjek procedurën e mëposhtme:

a) shqyrton dokumentacionin e paraqitur, sipas pikës 9 të këtij neni dhe, në rast se konstatohet mungesë apo paqartësi dokumentacioni, njofton menjëherë subjektin nëpërmjet portalit *e-Albania* për afatin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm;

b) në rast se subjekti nuk i plotëson kriteret sipas pikës 7, të këtij neni, dhe/ose dokumentacioni, pas kërkesës për plotësim, mbetet i paplotësuar brenda afatit të kërkuar, GTSHA-ja refuzon përfundimisht kërkesën nëpërmjet portalit *e-Albania*;

c) në rast se subjekti i plotëson kriteret sipas pikës 7 të këtij neni dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton i plotë, GTSHA-ja njofton subjektin nëpërmjet portalit *e-Albania* dhe njofton elektronikisht Agjencinë Kombëtare të Bregdetit (në vijim "AKB") dhe njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore (në vijim "NJVV"), me qëllim plotësimin e dokumentacionit shtesë, si më poshtë vijon:

i. planvendosja përkatëse për sipërfaqen konkrete të miratuar të stacionit të plazhit, pas negociimit ndërmjet subjektit të kualifikuar dhe NJVV-së, që do të jepet për shfrytëzim si stacion plazhi, përfshirë edhe brezin e shërbimeve, sipas rastit, e miratuar nga të dyja palët;

ii. gjenerimi i mandatpagesës vjetore të sipërfaqes së stacionit të plazhit, nga ana e NJVV-së si palë përfituese, sipas tarifave vendore në fuqi, ku të detajohet detyrimi financiar vjetor për përdorimin e sipërfaqes së stacionit të plazhit dhe për ngritjen e shfrytëzimin e strukturave të shërbimit, sipas rastit, si dhe vërtetimi i pagesës së kryer nga ana e subjektit. Në rast të kontratave disavjeçare të lidhura sipas këtij neni, NJVV-ja është përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të qirasë për çdo vit. Përpara fillimit të sezonit turistik të vitit pasardhës, NJVV-ja njofton zyrtarisht AKB-në për statusin e detyrimeve nga ana e subjekteve me të cilat është lidhur kontrata. Mospagesa e detyrimeve vjetore të qirasë përpara sezonit turistik nga ana e subjekteve përfituese përbën shkak për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës;

iii. pas plotësimit të dokumentacionit shtesë si më sipër, GTSHA-ja miraton në portalin *e-Albania* aplikimin përkatës dhe AKB-ja njofton menjëherë subjektin dhe NJVV-në për nënshkrimin e kontratës sipas formatit tip bashkëlidhur këtij vendimi. Para nënshkrimit të kontratës, subjekti duhet të paraqesë marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesin e plazhit (shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit), e vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

ç) në përfundim të nënshkrimit të kontratës, subjekti pajiset me certifikatën e përdorimit të stacioneve të plazhit, sipas modelit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.".

8. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12. Dorëzimi i hapësirës së plazhit bëhet, si më poshtë vijon:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, topografi i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore ndan me procesverbal në terren koordinatat e stacionit të plazhit dhe njofton policinë bashkiake për monitorimin e veprimtarisë;

b) një kopje e procesverbalit depozitohet pranë zyrës qendrore të AKB-së brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti hartimit të tij.".

9. Pikat 14 dhe 16 shfuqizohen.

10. Në fund të pikës 17 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Në plazhet publike, njësia e vetëqeverisjes vendore vendos sinjalistikë të dallueshme me shënimin "Plazh publik".".

11. Pikat 18 dhe 19 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"18. Parashikimet e përcaktuara në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar, zbatohen për aq sa është e mundur dhe kur nuk bien ndesh me parashikimet e këtij neni.

19. Kontratat ekzistuese shumëvjeçare mund të rinegociohen sipas parashikimeve të këtij neni.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCË
KONTRATA MODEL PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS SË PLAZHIT/KONTRATË QIRAJE

Sot, më datë [•], në [•], nënshkruhet kjo kontratë qiraje (Kontrata) ndërmjet palëve, si më poshtë:

Agjencia Kombëtare e Bregdetit përfaqësuar nga z./znj. [•], në cilësinë e Drejtorit të Agjencisë (Qiradhënësi)

dhe

[•], një shoqëri [•]/person fizik, i/e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikimi [•], me seli në adresën: [•], përfaqësuar nga z./znj. [•], në cilësinë e përfaqësuesit ligjor (Qiramarrësi),

këtu e më poshtë, së bashku, referuar si "Palët" dhe veç e veç si "Pala".

Njësia e Vetëqeverisjes Vendore, përfaqësuar nga ……., si përfitues,

meqenëse:

A) Qiramarrësi operon një strukturë akomoduese strukturë shërbimi të ndodhur në [•], me një kapacitet prej [•] (nëse aplikohet);

B) Mbështetur në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar, qiramarrësi ka depozituar pranë qiradhënësit, aplikimin për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit prej [•] m^2, të ndodhur në [•];

C) Qiramarrësi, mbështetur në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar, pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, është njoftuar, në datën [•], për miratimin e kërkesës për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit prej [•] m^2 të ndodhur në [•].

Për sa më sipër dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, palët bien dakord, si më poshtë vijon.

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e hapësirës së plazhit dhe/ose e shërbimit, sipas rastit, të ndodhur në [•], me sipërfaqe prej [•] m^2, në administrim të qiradhënësit, sipas listës së plazheve dhe hartës së tyre miratuar nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e hapësirës së plazhit dhe/ose e shërbimit sipas rastit, për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores, 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar.

Neni 3
Kohëzgjatja

1. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej __ viti/vjetësh, për sezonin turistik ____, për periudhën __ dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

2. Palët bien dakord që kontrata do të përfundojë me përfundimin e afatit dhe nuk do të rinovohet.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

1. Përfituesi (NJVV) dorëzon, brenda [•] ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, hapësirën e plazhit të përcaktuar në pikën 1, të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali

i dorëzimit të hapësirës së plazhit që jepet me qira, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

2. Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e qiramarrësit.

3. Qiradhënësi është i detyruar të garantojë qiramarrësin për gëzimin e qetë të hapësirës së plazhit, objekt të kontratës gjatë gjithë periudhës së qirasë. Ai garanton qiramarrësin nga çdo pretendim apo të drejta nga palë të tjera në përdorimin e qetë të hapësirës së plazhit, objekt qiraje.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

1. Qiramarrësi ka të drejtë të përdorë e të gëzojë pronën e marrë në qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

2. Qiramarrësi detyrohet që:

2.1 të përdorë hapësirën e plazhit, objekt të kësaj kontrate, vetëm për qëllimin e parashikuar në nenin 2;

2.2 të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me planin e operimit të paraqitur në momentin e aplikimit për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit;

2.3 të plotësojë e të respektojë kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë të përcaktuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar.

3. Qiramarrësi detyrohet të bashkëpunojë me çdo autoritet publik përgjegjës për monitorimin dhe inspektimin e plazhit e të veprimtarive turistike, si dhe t'u japë atyre akses në të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve ligjore përkatëse.

4. Qiramarrësi detyrohet të paraqesë te qiradhënësi çdo dokumentacion të nevojshëm për përmbushjen e kritereve dhe standardeve minimale për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit.

5. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me nënqira hapësirën e plazhit të marrë me qira, sipas kontratës.

6. Qiramarrësi detyrohet të ketë të punësuar vrojtues plazhi përgjatë gjithë sezonit të ushtrimit të veprimtarisë së plazhit.

7. Qiramarrësi detyrohet të afishojë certifikatën e përdoruesit të hapësirës së plazhit, certifikatën e kualifikimit të vrojtuesit të plazhit ose kopja e saj, së bashku me NIPT-in dhe lejet që ai disponon.

Neni 6
Zgjidhja e kontratës

1. Kontrata zgjidhet me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 3.1, të kontratës.

2. Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) kur subjekti nuk ka paguar detyrimin vjetor të qirasë;

b) në marrëveshje midis palëve;

c) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet, për shkak të një force madhore, aq sa nuk mund të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit;

ç) kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër sipas kontratës dhe kriteret e standardet e parashikuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar.

Në rastet e lartpërmendura, kontrata do të zgjidhet me përfundimin e afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e dërgimit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës.

3. Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit me shkrim të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara.

4. Me përfundimin e kontratës, qiramarrësi duhet të kthejë hapësirën e plazhit në të njëjtën gjendje që e ka marrë në dorëzim; në të kundërt, detyrohet të kryejë të gjitha rregullimet me shpenzimet e veta ose të paguajë vlerën përkatëse të shpenzimeve të përcaktuara me një ekspert të emëruar me marrëveshje dypalëshe.

5. Me përfundimin e kontratës, qiramarrësi ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga hapësira e plazhit, por pa dëmtuar atë. Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve të kryera nga qiramarrësi.

Neni 7
Dispozitat e fundit

1. Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil dhe vendimit nr. [•], datë

[•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar.

2. Kontrata përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve lidhur me objektin e saj dhe ka epërsi mbi çdo marrëveshje të mëparshme me gojë apo me shkrim midis palëve.

3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve lidhur me kontratën apo ndonjë marrëveshje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e kontratës, do të zgjidhet nga palët me mirëkuptim; në të kundërt, zgjidhja e mosmarrëveshjes do të jetë në kompetencën e gjykatës administrative përkatëse.

4. Kontrata është hartuar në katër kopje origjinale, në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë secila.

VENDIM
Nr. 1173, datë 24.12.2020

PËR TRANSFERIMIN NË FONDIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE ME NR. 277, 344/1 DHE 345/1, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME PREJ 41,463 m^2, NË ZONËN KADASTRALE 2371, NË FSHATIN LAJTHIZË, BASHKIA FUSHË-ARRËS, NË PRONËSI TË BASHKISË FUSHË-ARRËS, SI DHE VËNIEN E TYRE NË DISPOZICION PËR ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK "KOMPLEKSI TURIZËM RURAL LAJTHIZA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike, i cili administrohet nga ministria përgjegjëse për ekonominë, të pronave të paluajtshme shtetërore me nr. 277, 344/1 dhe 345/1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 41,463 m^2, kategoria e resursit "pyll", në zonën kadastrale 2371, në fshatin Lajthizë, Bashkia Fushë-Arrës, në pronësi të Bashkisë Fushë-Arrës, sipas aneksit 1, kartelave të pasurisë dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Pasuria e paluajtshme shtetërore, e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, të vihet në dispozicion për zhvillimin dhe realizimin e projektit të investimit strategjik "Kompleksi Turizëm Rural Lajthiza", me subjekt investues "Lajthiza Invest" sh.a., me NIUS J98009202P.

3. Vënia në dispozicion e pasurisë së paluajtshme shtetërore bëhet për 30 (tridhjetë) vjet me tarifën 1 euro. Afati i përdorimit fillon nga data e nënshkrimit të kontratës së qirasë, ndërmjet ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe subjektit investues.

4. E drejta e përdorimit të tokës shtetërore nga investitori strategjik "Lajthiza Invest" sh.a., me NIUS J98009202P, dhe detyrimet e kushtet e përdorimit do të bazohen në vendimin nr. 36/6, datë 24.6.2020, të Komitetit të Investimeve Strategjike dhe kontratën e qirasë që do të nënshkruhet ndërmjet subjektit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

5. Aplikimi për leje/licenca/autorizime për realizimin e investimit strategjik "Kompleks Turizëm Rural Lajthiza" realizohet sipas legjislacionit të investimeve strategjike.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Bashkia Fushë-Arrës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës Pukë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe


RILEVIM TOPOGRAFIK
BASHKIA FUSHE-ARRËZ
LAJTHIZE
LEGJENDE
Edison
Sinanaj
Digitally signed
by Edison
Sinanaj
Date: 2020.11.16
13:36:12 -08'00'


RILEVIM TOPOGRAFIK
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
LAJTHIZE
LEGJENDË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 196904

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit: VRRP-FUSHË Zona Kadastrale Nr. 1711

Numri i Pasurisë: 277 Volumi: 2 Faqe: 40

Adresa e Pasurisë: ATIHIZE

Lloji i Pasurisë: TOKË

Sipërfaqja Totale: 22117,00 m2

Nga kjo: Sa Tokë: Nga kjo: Sa Ndërtesa:

Nga pallati: Kuota e pjesëmarrjes:

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zona (Zonat):

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
BASHKËS	MUSTAFA	ARBËR	1/1	[illegible]

Është pronar: i pasurisë me numër: 277

Jane bashkëpronarë sipas pjesëve me lart:

Është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi:

Kufizimet e pasurisë janë: V: I: H:

Kjo certifikatë bëhet njohur në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Kjo certifikatë lëshohet si pasqyrë e saktë e paraqitur nga i (shërbyesi) me datë: 17/12/2020 Nr.

Lëshuesi i certifikatës REGJISTRUESI

Data e lëshimit të certifikatës: 17/12/2020

K. M. Nr. 519, Date 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 2, Fq. 40

NI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

-> Vijon nga Vol _____, Fq. _____

Kadastrale: 2371 NR.i PASURISE: 277

Vijon ne: Vol _____, Fq. _____ deri ne: Vol _____, Fq. _____ ->

Fleksi i Hartes: K-34-65-(181-D)

Adresa e Pasurisë: Rrethi PUKË Q/F LAJTHIZE

PERFUNDIMTARE (data): _____

Rr/L _____ P/G ____ SH ___ K ___ Ap ___

Pershkrim i veçanët:

REGJISTRIM I PJESSHEM I PARCELES PYJORE 35a

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: PYLL Brenda V.K.N.: PO , Ref PL. RREGULL UES

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë
1. 16,519.00 m^2 Ref LN 05.05	1. _____ m^2 Ref. _____	1. _____ m^2 Ref. _____
2. 10,465.00 m^2 Ref 00000043	2. _____ m^2 Ref. _____	2. _____ m^2 Ref. _____
3. 22,117.00 m^2 Ref 00000046	3. _____ m^2 Ref. _____	3. _____ m^2 Ref. _____
4. _____ m^2 Ref _____	4. _____ m^2 Ref. _____	4. _____ m^2 Ref. _____

Per pjesen e perbashkët: PALLAT

Kuota e pjesëmarjes: _____ %

Nr i Pasurisë (pallat): _____

Vol ____ Faqe ____

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
00000046	13/03/2020	BASHKIA FUSHE ARREZ		I	QAFE-MAL		13/03/2020	VKM 433, DT 08.06.2016	

Shënim. Kolona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - pëlqeuesit i familjes; B - bashkëpronësi (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PUKË
Adresa: Rruga 11 Nentori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)
PUKË, me 17 / 7 / 2020
SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë
Në regjistrin Vol. 1, Faqe 40, Zona Kadastrale 2371, Qyteti Pukë

REGJISTRUESI
Gjoke Zhjolli

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
PUKË

REGJISTRUESI

Vula/Firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 2371
NR. I PASURISE: 277 VOL 2 FQ 40
INDEKSI I HARTES: K-34-65-(181-D) SHKALLA: 1:2500
ADRESA E PASURISE: Rrethi PUKË O/F LAJTHIZE
Rr/L: P/G SH K Ap

B. KUFIZIMET
V. 276
L. 257
J. 224
P. 279/1

C. PRONARI
BASHKIA FUSHE ARREZ

D. Data: 7/17/2020 Ora: 11:49:19AM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË

PËR VËRTETIM PRONËSIE

196908

Zyra e Regjistrimit: VRIPERUKË

Zona kadastrale Nr. 7371

Numri i Pasurisë: 1441

Vëllimi: 2 Faqe: 112

Adresa e Pasurisë: ADUHKË

Lloji i Pasurisë: PYLL

Sipërfaqja totale: 13683 m2

Nga kë: Ga Trudi

Nga kë: Ga Ndërtesa

Nga palët: Kuota e pjesëmarrjes

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti / Zonjës

Emri Atësia Mbiemri Plasa Adresa

BASHKIA PËRPUJË KRIZ

Është pronar i pasurisë me numër 1441

Janë bashkëpronarë e gëzojnë pjesëve me larë

Është përfaqësues familjesë e cila ka në pronësi

Kuotën dhënë janë

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Kjo certifikatë lëshohet vetëm kërkesës së paraqitur nga Li(ta) interesuari(t) me datë 29/4/2020 Nr. 438

Data e lëshimit të certifikatës 29/4/2020

Lëshuesi certifikatës REGJISTRUESI

r. 319, Datë 7.11.1994 **KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME**

Vol. 2, Fq. 112

DËNTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijon nga Vol. _____, Fq. _____

trale: 2371 NR.i PASURISE: 344/1

Vijon në: Vol. _____, Fq. _____ deri në: Vol. _____, Fq. _____ -->

i Hartes: K-34-64-(181-D)

ia e Pasurisë: Rrethi PUKË Q/F LAJTHIZE

PERFUNDIMTARE (data): _____

Rr/L _____ P/G ____ SH ___ K ___ Ap ___

Pershkrim i veçantë

Parcela 32a/1 e

SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: PYLL Brenda V.K.N.: PQ, Ref PL RREGULLUES

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë
1. 14,568.00 m² Ref 00000047	1. _____ m² Ref _____	1. _____ m² Ref _____
2. _____ m² Ref _____	2. _____ m² Ref _____	2. _____ m² Ref _____
3. _____ m² Ref _____	3. _____ m² Ref _____	3. _____ m² Ref _____
4. _____ m² Ref _____	4. _____ m² Ref _____	4. _____ m² Ref _____

Per pjesen e pëthajtësit: PALLAT

Kuota e pjesëmarjes: _____ %

Nr i Pasurise (pallat):

Vol. ___ Faqe ___

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
00000047	29/07/2020	BASHKIA FUSHE ARRËZ		I	QAFE-MAL		29/07/2020	NDAPASURIE	

Shënim: Kolona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESIJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PUKË
Adresa: Rruga 11 Nëntori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)
PUKË, me 29 / 7 / 2020
SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në syrën tonë
Në regjistrin Vol 3 , Faqe 112 , Zona Kadastrale 2371, Qyteti Pukë

REGJISTRUESI
Gjoke Nikolli

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME PUKË	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
REGJISTRUES Gjoke Nikolli	ZONA KADASTRALE 2371
	NR. I PASURISE: 344/1 VOL 2 FQ 112
	INDEKSI I HARTES: K-34-64-(181-D) SHKALLA: 1:2500
	ADRESA E PASURISE: Rrethi PUKË Q/F LAJTHIZE
	Rr/L: P/G SH K ___Ap
	B. KUFIZIMET / C. PRONARI
	V. 227 — BASHKIA FUSHE ARRËZ
	L. 345/1
	J. 344/2
	P. 344/2
Vula/Firma	D. Data: 7/29/2020 Ora: 4:35:03PM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 196911

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit: VK PP PUKË Zona Kadastrale Nr. 3751

Numri i Pasurisë: 4391 Vëllimi: 2 Faqe: 114

Adresa e Pasurisë: AJUHIZE

Lloji i Pasurisë: PYLL

Sipërfaqja totale: 4778.00 m2

Nga Kio: Sa Truall: Nga Kio: Sa Ndërtesa:

Nga pallati: Kupta e pjesëmarrjes:

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë):

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
BASHKIA	PUSHI	ARRIZ	1/1	PUKË

është pronar i pasurisë me numër 4391

janë bashkëpronarë sipas pjesëve me larë:

janë përfaqësues i familjes e cila kanë pronësi:

kuti zimet e pasurisë janë: V: L: R:

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) me datë 29/7/2020 Nr. 4201

Data e lëshimit të çertifikatës: 29/7/2020

Lëshuesi i certifikatës: REGJISTRUESI

/. K. M. Nr. 519, Date 7.11.1994 **KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME**

Vol. 2, Fq. 114

--> Vijon nga: Vol. _____, Fq. _____

Vijon në: Vol. _____, Fq. _____ dmi në: Vol. _____, Fq. _____ -->

PERFUNDIMTARE (data): _____

ONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

a Kadastrale: 2371 NR. i PASURISE: 345/1

ndeksi i Hartes: K-34-64-(181-D)

Adresa e Pasurisë: Rrethi PUKË Q/F LAJTHIZE

Rr/L. _____ P/G ____ SH ___ K ___ Ap ___

Përshkrim i veçantë:

Parcela 328/1

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: FYLL Brenda V.K.N. : PO , Ref PL RREGULL UES

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë
1. 4,778.00 m^2 Ref 00000048	1. _____ m^2 Ref. _____	1. _____ m^2 Ref. _____
2. _____ m^2 Ref _____	2. _____ m^2 Ref. _____	2. _____ m^2 Ref. _____
3. _____ m^2 Ref _____	3. _____ m^2 Ref. _____	3. _____ m^2 Ref. _____
4. _____ m^2 Ref _____	4. _____ m^2 Ref. _____	4. _____ m^2 Ref. _____

Per pjesen e përbashkët: PALLAT

Kuota e pjesëmarrjes: _____ %

Nr i Pasurise (pallat): _____

Vol. ____ Faqe ____

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimi	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
00000048	29/07/2020	BASHKIA PUSHIM ARREZ		I	QAFE-MAL		29/07/2020	ND PASURIE	

Shënim: Kolona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik, F - familjarisht, B - bashkëpronësi (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PUKË
Adresa: Rruga 11 Nentori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)
PUKË, me 29 / 7 / 2020
SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë
Në regjistrin Vol 2, Faqe 114, Zona Kadastrale 2371, Qyteti Pukë

REGJISTRUESI
Gjoke Nikolli

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
PUKË

REGJISTRUES

Vula/Firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 2371
NR. I PASURISE: 345/1 VOL 2 FQ 114
INDEKSI I HARTES: K-34-64-(181-D) SHKALLA: 1:2500
ADRESA E PASURISE: Rrethi PUKË Q/F LAJTHIZE
Rr/L.: P/G SH K ___Ap

B. KUFIZIMET
V. Rruge
L. 345/2
J. 345/2
P. 344/2

C. PRONARI
BASHKIA FUSHE ARRIZ

D. Data: 7/29/2020 Ora: 4:59:43PM



VENDIM
Nr. 35, datë 27.1.2021

PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2021, NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2021 është, gjithsej, 705 (shtatëqind e pesë), të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

a) për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues 4;
b) për kategorinë e mesme drejtuese 60;
c) për kategorinë e ulët drejtuese 169;
ç) për kategorinë ekzekutive 472.

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike;
- Audit i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;
- Histori-filologji;
- Shkenca mjekësore;
- Veterinari;
- Agronomi;
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
- Kimi;
- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Shkenca inxhinierike;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Arte të bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca ekzakte;
- Shkenca edukimi;
- Mësuesi;
- Arsim i lartë ushtarak/policor;
- Arsim i lartë.

3. Institucionet e administratës shtetërore, ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2021, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

LISTA E INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE KU PLANIFIKOHEN VENDET VAKANTE GJATË VITIT 2021

1. Kryeministria dhe institucionet e saj të varësisë;
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
3. Sistemi i Ministrisë së Brendshme;
4. Ministria e Mbrojtjes;
5. Sistemi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
6. Sistemi i Ministrisë së Drejtësisë;
7. Sistemi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
8. Sistemi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Sistemi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
10. Sistemi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
11. Sistemi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
12. Ministria e Kulturës.

VENDIM
Nr. 38, datë 27.1.2021

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË AFATMESME TË MENAXHIMIT TË BORXHIT, 2021–2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, 2021–2023, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

STRATEGJIA AFATMESME E MENAXHIMIT TË BORXHIT 2021–2023

Janar 2021

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE
MENAXHIMI I BORXHIT
I.SITUATA E BORXHIT TË QEVERISJES QENDRORE
1.Ecuria e borxhit të qeverisjes qendrore
2.Realizimi i huamarrjes
2.1 Huamarrja e brendshme
2.2 Huamarrja e huaj
3.Portofoli i borxhit shtetëror
4.Portofoli i borxhit shtetëror të garantuar
5.Menaxhimi i kostove dhe i risqeve
5.1 Kostot
5.2 Risqet
6.Zhvillimet e tregut primar të titujve shtetërorë
6.1 Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për tituj shtetërorë
6.2 Ecuria e normave të interesit
II.STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË BORXHIT
1.Supozimet bazë
1.1 Zhvillimet aktuale dhe pritshmëritë në sektorin real, sektorin e jashtëm, atë financiar dhe sektorin fiskal
1.2 Vlerësime referuar borxhit ekzistues, tregjeve të instrumenteve financiare dhe faktorëve makroekonomikë
1.3 Burimet e financimit
1.3.1 Burimet e brendshme
1.3.2 Burimet e huaja
2.Strategjia afatmesme
2.1 Menaxhimi/kontrolli i kostove dhe i risqeve
2.1.1 Kostot
2.1.2 Menaxhimi i risqeve
2.2 Zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë
2.2.1 Rritja e likuiditetit
2.2.2 Rritja e eficiencës
2.2.3 Rritja e transparencës
2.3 Menaxhimi i borxhit shtetëror të garantuar
2.3.1 Kriteret bazë për emetimin e garancive shtetërore
2.3.2 Niveli i garancive shtetërore
2.4 Pritjet e treguesve bazë dhe analiza e ndjeshmërisë
2.4.1 Niveli i borxhit të qeverisjes qendrore
2.4.2 Shërbimi i borxhit shtetëror
2.4.3 Analiza e ndjeshmërisë
ANEKS I
ANEKS II
ANEKS III

PËRMBLEDHJE

Objektivat dhe qëllimi

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMB) është një plan afatmesëm, të cilin Ministria e Financave dhe Ekonomisë synon ta zbatojë duke pasur si objektiva parësorë:

- Plotësimin e nevojave të qeverisë për financim në kohë, si edhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët, duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve;
- Përmirësimin dhe ruajtjen e eficiencës së tregut primar, mbështetur nga zhvillimi i mëtejshëm i tregut sekondar të titujve shtetërorë vendës.

Në funksion të realizimit të objektivave të sipërpërmendur dhe në përputhje me bazën ligjore në fuqi[2], Ministria e Financave dhe Ekonomisë përgatit dhe përditëson në bazë vjetore dokumentin e SAMB-së, duke parashtruar planet e financimit me borxh dhe aktivitetet që do të ndërmerren në periudhën afatmesme.

SAMB-ja hartohet dhe përditësohet në linjë me ligjin vjetor të buxhetit, kuadrin makroekonomik dhe fiskal të qeverisë, si edhe me politikat monetare që Banka e Shqipërisë planifikon të zbatojë në periudhën afatmesme 2021–2023.

Qëllimi i SAMB-së është:

[2] Neni 6 i ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

- të menaxhojë me efikasitet portofolin e borxhit të qeverisjes qendrore, në të cilin përfshihet borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas;
- të rrisë transparencën ndaj investitorëve dhe palëve të interesuara, në lidhje me planet e huamarrjes së qeverisë; si edhe
- të qartësojë dhe të kuantifikojë objektivat në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Perspektiva afatmesme

SAMB-ja 2021–2023, në periudhën afatshkurtër do të ketë në fokus plotësimin e nevojave për huamarrje, në kuadër të rimëkëmbjes së ekonomisë pas situatës së krijuar nga tërmeti i muajit nëntor 2019 dhe pandemisë COVID-19, ndërkohë në periudhën afatmesme do të synojë përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjes nën kontroll të kostos. Në këtë drejtim, prioritet do të mbetet zgjatja e jetëgjatësisë së borxhit nëpërmjet uljes së mëtejshme të përqendrimit të titujve afatshkurtër në portofol.

Në vijim të situatës së jashtëzakonshme të krijuar nga pandemia në nivel global COVID-19, periudha afatmesme 2021–2023 përbën një sfidë, në lidhje me menaxhimin e borxhit publik, në veçanti me sigurimin e financimit në kushtet ku nevojat për financim janë rritur, duke synuar njëkohësisht qëndrueshmërinë e tij.

Financimi i brendshëm do të jetë në linjë me kapacitetet normale absorbuese të tregut. Nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do të synohet rifinancimi i titujve ekzistues që maturohen, menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet, si edhe përmirësimi i profilit vjetor të maturimeve. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të mbulohet financimi i deficitit.

Në periudhën afatmesme huamarrja e huaj planifikohet të mbulojë mesatarisht rreth 20% të nevojave të përgjithshme për hua të qeverisë dhe do të mbështetet kryesisht në: i. huat me terma pjesërisht të butë, të cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria për zhvillimin e vendit; ii. huat me terma të butë, të akorduara nga institucionet ndërkombëtare financiare për të mbështetur vendin për t'u rimëkëmbur nga dy fatkeqësitë: tërmeti i nëntorit 2019 dhe përhapja e pandemisë COVID-19, si edhe për të mbështetur politikat zhvillimore dhe reformat e ndërmarra nga qeveria; si edhe iii. instrumentet financiare të tregjeve të kapitalit mbi baza oportuniste, kryesisht për të mundësuar menaxhimin e detyrimeve të borxhit në valutë dhe për të optimizuar risqet e portofolit.

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut primar vendës dhe hedhja e hapave për zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë është një tjetër objektiv parësor i strategjisë afatmesme. Realizimi i suksesshëm i këtij objektivi do të pasohej me kosto dhe risqe më të ulëta për të gjithë aktorët e tregut, duke përfshirë qeverinë, si edhe investitorët e titujve shtetërorë.

Procesi gjatë të cilit do të synohet të përmbushet ky objektiv do të shtrihet në periudhën afatmesme dhe afatgjatë dhe do të kaloj nëpërmjet hallkave të mëposhtme:

- zhvillimit të kurbës së *yield*-ve në drejtim të titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë, nëpërmjet krijimit dhe konsolidimit të madhësive *benchmark*, si edhe reduktimit të fragmentimit të kërkesës;
- përshtatjes së politikave të huamarrjes (përfshirë shitjen, parablerjen dhe shkëmbimin e titujve shtetërorë) me kushtet e tregut dhe kërkesën për tituj të caktuar;
- rritjes së transparencës nëpërmjet konsultimit të vazhdueshëm me aktorët kryesorë të tregut dhe raportimit e publikimit në kohë të rezultateve të ankandeve të titujve shtetërorë;
- edukimit të investitorëve në lidhje me titujt qeveritare;
NP-11	Ndërtime për n/stac., kab. e transform. e linjës TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	1		}
		2		
		3		
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit	1		}
		PUNIME SPECIALE		
KATEGORIA/PUNIMI				
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	1		}
		2		
		3		
NS-2	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	1		}
		2		
		3		
		4		
		5		
NS-3	Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)	1		}
		2		}
		3		
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	1		}
		2		
		3		
		4		
		5		
		6		
NS-5	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut	1		}
		2		
		3		

		4		
		5		
NS-6	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese	1		}
		2		
		3		
		4		
		5		
		6		
		7		
NS-7	Barriera dhe mbrojtje rrugore	1		}
		2		
NS-8	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	1		}
		2		
		3		
		4		
NS-9	Punime strukturore speciale	1		}
		2		
		3		
		4		
		5		
NS-10	Shtresa dhe mbistruktura speciale	1		}
		2		
NS-11	Punime mbi shina dhe traversa	1		}
		2		
		3		
NS-12	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit	1		}
		2		
		3		
		4		

		5		
NS-13	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	1		}
		2		
		3		
NS-14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.	1		}
		2		
		3		
		4		
		5		
NS-15	Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore	1		}
NS-16	Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij	1		}
		2		
		3		
NS-17	Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane	1		}
		2		
NS-18	Punime topogjeodezike	1		}
		2		
		3		
		4		
		5		
NS-19	Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë	1		}
		2		
NS-20	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë	1		}
		2		

Drejtuesi ligjor
(emir, mbiemri, firma)

Drejtuesi teknik
(emir, mbiemri, firma)

VENDIM
Nr. 44, datë 27.1.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE DHE MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, DHE KONFEDERATËS SË ZVICRËS, TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM (SDC), E DEPARTAMENTIT FEDERAL TË PUNËVE TË JASHTME TË ZVICRËS, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET AMBASADËS ZVICERANE NË SHQIPËRI, MBI PROGRAMIN "PROMOCIONI SHËNDETËSOR DHE PARANDALIMI I SËMUNDJEVE KRONIKE NË SHKOLLA", FAZA PËRGATITORE, NJË PROJEKT BILATERAL BASHKËPUNIMI DHE ZHVILLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe Konfederatës së Zvicrës, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës, duke vepruar nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, mbi programin "Promocioni shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve kronike në shkolla", faza përgatitore, një projekt bilateral bashkëpunimi dhe zhvillimi, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS SË ZVICRËS, TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM (SDC), E DEPARTAMENTIT FEDERAL TË PUNËVE TË JASHTME TË ZVICRËS, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET AMBASADËS ZVICERANE NË SHQIPËRI
MBI:
PROGRAMIN E PROMOVIMIT SHËNDETËSOR DHE PARANDALIMIT TË SËMUNDJEVE KRONIKE NË SHKOLLA

Faza përgatitore
Një Projekt Bilateral Bashkëpunimi dhe Zhvillimi

Në përpjekje për të forcuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve,

Në zbatim të marrëveshjes kuadër në lidhje me Bashkëpunimin Teknik dhe Financiar dhe Ndihmën Humanitare ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë Shqiptare, të nënshkruar më 11 maj 2007 dhe të ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9801, datë 13 shtator 2007,

Në respektim të parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut – siç përcaktohet veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut – që frymëzojnë politikat e brendshme dhe të jashtme të të dyja Palëve dhe përbëjnë element thelbësor me mundësi të barabarta me objektivat e kësaj marrëveshjeje,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Kushtet e përgjithshme dhe përkufizimet

Kudo që përdoren në këtë marrëveshje, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Palë Kontraktuese" nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverinë e Konfederatës Zvicerane;

b) "Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë" nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes Sociale dhe nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

c) "Konfederata Zvicerane" përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim (SDC) dhe Bashkëpunim e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës;

d) "Projekt" nënkupton programin "Promovimi Shëndetësor dhe Parandalimi i Sëmundjeve Kronike në Shkolla";

e) "SDC" nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës;

f) "Grant" nënkupton kontributin e dhënë nga Qeveria Zvicerane sipas kësaj marrëveshjeje;

g) "Partner zbatues" nënkupton organizatën joqeveritare Save the Children Switzerland (Zvicër).

Neni 2
Autoritet përgjegjëse

1. Përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjes do të jenë autoritetet e mëposhtme:

a) Për Konfederatën Zvicerane:

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e përfaqësuar nga Ambasada e Zvicrës në Shqipëri.

b) Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

2. SDC-ja, si autoriteti përgjegjës i palës zvicerane, do t'i besojë zbatimin e projektit organizatës jofitimprurëse Save the Children Switzerland, si shoqëri fituese e tenderit me procedurë të hapur.

Neni 3
Qëllimet dhe objektivat

1. Marrëveshja do të ketë si qëllim zbatimin e fazës përgatitore të projektit.

Faza përgatitore ka objektiv kryesor përcaktimin e ndërhyrjeve në fazën kryesore të zbatimit të projektit.

2. Në fazën përgatitore të projektit synohet arritja e rezultateve kryesore si më poshtë:

- Një analizë e detajuar e situatës së *përfituesve* kryesorë të projektit (*alias*, audienca e synuar ose grupet e popullatës).

- Një analizë e detajuar e situatës së të gjitha *shkollave* dhe *institucioneve* kryesore (nga sektori i shëndetësisë, sektori i arsimit dhe pushteti lokal) të përfshira në projekt, duke përfshirë vlerësimin e kushteve dhe situatës aktuale, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me aktivitetet dhe programet e promovimit shëndetësor me nxënësit e moshave shkollore.

- Bazuar në dy analizat e situatave të lartpërmendura, identifikimin e qasjes më të përshtatshme ndërhyrëse (dokumentit të projektit) dhe një modeli të zbatueshëm në kontekstin shqiptar, i cili do të nxisë ndryshimin e sjelljeve pozitive te nxënësit e shkollave, duke promovuar modele të shëndetshme të sjelljes dhe praktikave të shëndetshme të mënyrës së jetesës.

3. Për të arritur objektivat e kësaj marrëveshjeje, autoritetet përgjegjëse bashkëpunojnë me sektorin publik dhe privat, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në:

Institutin e Shëndetit Publik, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Operatorin e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe entet e tij rajonale, Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Drejtorinë e Përgjithshme për Arsimin Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe grupet e interesit.

Neni 4
Detyrimet e palëve kontraktuese

1. Konfederata Zvicerane, si palë kontraktuese, e përfaqësuar sipas parashikimeve më lart, në zbatim të kësaj marrëveshjeje:

a) Angazhon, deri më datë 28 shkurt 2021, fonde në formë të një granti të parimbursueshëm ekuivalent me një shumë maksimale prej CHF 666'700 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) franga zvicerane, që do të përdoren ekskluzivisht për zbatimin e projektit sipas qëllimeve dhe objektivave të përcaktuar në nenin 3;

b) Ky grant nuk mund të përdoret për asnjë qëllim tjetër përveç atij të përmbushjes së projektit. Çdo pjesë e pashfrytëzuar e grantit, që mbetet në fund të projektit është objekt i rifinancimit të Konfederatës Zvicerane;

d) Granti do të disbursohet dhe auditohet sipas dispozitave të kontratës ndërmjet SDC-së dhe partnerit zbatues.

2. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar sipas parashikimeve më lart:

a) vendos se do të veprojnë si bashkëpërgjegjëse për strategjinë e projektit dhe si bashkëdrejtuese në mbledhjet e Komitetit Drejtues Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

b) siguron lidhjen e projektit me politikat kombëtare dhe kuadrin ligjor përkatës për prioritetet në sektorin e shëndetësisë, në mënyrë që të mundësojë dhe promovojë koherencën e objektivave të projektit me kushtet e kuadrit kombëtar;

c) mbështet lehtësimin dhe shpërndarjen e përvojave dhe informacionit bazuar në rezultatet e arritura dhe ndikimet e projektit në nivel kombëtar;

d) përkrah dhe lehtëson lidhjen dhe bashkëpunimin me ministritë dhe institucionet e tjera;

e) siguron reagimin dhe bashkëpunimin e strukturave të varësisë në nivel rajonal dhe /ose lokal;

f) mbështet dhe ndihmon në zbatimin e aktiviteteve hulumtuese;

g) vë në dispozicion alokimin e nevojshëm të buxhetit për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në lidhje me fazën përgatitore të projektit për një shumë maksimale prej CHF 80'000 (tetëdhjetë mijë franga zvicerane). Buxheti i nevojshëm për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) do të vendoset në dispozicion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

h) Këshilli i Ministrave u jep ekspertëve të huaj të angazhuar sipas kësaj marrëveshjeje dhe familjeve të tyre një përjashtim të të gjitha taksave gjatë vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje, sipas nenit 4.1, pika "b", të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Teknik-Financiar dhe Ndihmën Humanitare.

Neni 5
Menaxhimi i Projektit

a) Projekti është një ndërmarrje e përbashkët midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe SDC-së nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës;

b) Konfederata Zvicerane ka mandatuar Save the Children Switzerland si agjenci zbatuese për projektin. Kjo agjenci zbatuese merr përsipër të gjitha detyrat operative, administrative dhe mbikëqyrëse të projektit, duke përfshirë disbursimet, monitorimin dhe raportimin;

c) SDC-ja mund të mandatojë ekspertë të huaj dhe lokalë afatgjatë dhe afatshkurtër për të mbështetur zbatimin e projektit në konsultim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë bazuar në planin vjetor të aktiviteteve të miratuar nga komiteti drejtues i projektit;

d) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve që do të dakordësohen në kuadër të zbatimit të projektit; bashkëdrejtojnë mbledhjet e Komitetit Drejtues; sigurojnë akses në informacionin përkatës, duke përfshirë të dhënat statistikore që çmohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të projektit. Informacioni do të përdoret vetëm për qëllimet e Projektit.

Neni 6
Mbikëqyrja dhe bashkërendimi

1. Për të siguruar mbikëqyrjen e përgjithshme, cilësinë, rëndësinë dhe bashkërendimin e projektit, si dhe për të trajtuar çështjet e politikave, do të funksionojë Komiteti Drejtues, i cili do të mblidhet të paktën dy herë në vit (normalisht në muajin prill dhe tetor).

2. Komiteti Drejtues do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë me të drejtë për të vendosur dhe 5

(pesë) anëtarë me status vëzhguesi dhe do të bashkëkryesohet nga palët kontraktuese, si më poshtë:

a) Anëtar me të drejtë për të vendosur:

1 përfaqësues i Ambasadës së Zvicrës në Republikën e Shqipërisë (bashkëkryetar);

1 përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (bashkëkryetar);

1 përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (bashkëkryetar);

1 përfaqësues i Institutit të Shëndetit Publik;

1 përfaqësues i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;

1 përfaqësues i Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor;

1 përfaqësues i Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

b) Anëtar me status vëzhguesi;

1 përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shëndeti publik/Kujdesi Parësor;

1 përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

1 përfaqësues i Departamentit të Shëndetit Publik;

1 përfaqësues i UNFPA-së/UNICEF-it;

1 përfaqësues i FAO-s.

Sipas nevojës dhe temës së diskutimit, grupe të tjera interesi mund të ftohen të marrin pjesë në rolin e vëzhguesit.

Sekretariati i Komitetit Drejtues ofrohet nga partneri zbatues. Drejtuesi i ekipit të projektit merr pjesë në takim pa të drejtë vote.

3. Komiteti Drejtues do të arrijë kuorum vetëm kur të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët me të drejtë për të vendosur. Vendimet merren me unanimitet të të gjithë anëtarëve të pranishëm me të drejtë për të vendosur. Nëse nuk mund të arrihet unanimiteti, do të fillojnë një proces negocimi. SDC-ja, si autoritet përgjegjës përfaqësues i palës Zvicerane rezervon të drejtën e vendimit përfundimtar në rast se nuk arrihet konsensus në përfundim të procesit të negocimit.

Komiteti Drejtues do të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Rishikimi dhe diskutimi i progresit në lidhje me të gjitha aspektet e promovimit shëndetësor (p.sh. qasja ndërsektoriale mbi promovimin e shëndetit, promovimi i shëndetit në shkolla, kapacitetet e mësuesve, ndryshimet në kurrikula, mekanizmat financues të promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve kronike etj.);

b) Shqyrton dhe miraton raporte gjashtëmujore dhe vjetore të progresit të projektit, duke përfshirë statusin e shpenzimeve ndaj buxhetit;

c) Jep komente dhe miraton Planin Vjetor të Aktiviteteve të dorëzuara në SDC;

d) Monitoron ecurinë e zbatimit të projektit kundrejt objektivave/treguesve dhe planeve vjetore të punës;

e) Udhëzon aktivitetet kërkimore dhe të monitorim/vlerësimit gjatë zbatimit të projektit;

f) Ofron udhëzime për Projektin për përafrimin e veprimtarive të detajuara vjetore në përputhje me prioritetet kombëtare;

g) Kërkon asistencë teknike të specializuar të harmonizuar në fushat kyçe, kur është e nevojshme;

h) Identifikon, diskuton dhe propozon zgjidhje për problemet e mundshme të reformës shëndetësore në Shqipëri dhe masat e nevojshme.

Takimi i paplanifikuar mund të kërkohet me kërkesë të një prej anëtarëve të Komitetit Drejtues. Takimet bashkëkryesohen nga palët kontraktuese.

Palët Kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra tjetrën dhe në masën e arsyeshme praktike, do të konsultohen me njëra-tjetrën në lidhje me çdo rast që ndërhyn ose rrezikon të ndërhyjë në zbatimin e suksesshëm të projektit.

Neni 7

Prokurimi i mallrave dhe i shërbimeve

a) Mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga të ardhurat e kontributit zviceran, do të prokurohen nga Save the Children Switzerland në përputhje me pragun/kufirin e caktuar në zbatim të ligjit zviceran për prokurimin publik.

b) Për kohëzgjatjen e Projektit, mallrat e siguruara me fonde të SDC-së për përdorim në Projekt do të mbeten në dispozicion të pakufizuar të Projektit dhe nuk do të devijohen nga Projekti pa miratimin paraprak me shkrim të SDC-së;

c) Nëse për çfarëdo arsye Projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të ofruara me kontributin zviceran do të vendoset me shkrim nga Palët;

d) Në fund të projektit, SDC-ja do të vendosë mbi pronën dhe përdorimin e mallrave të prokuruara gjatë kohës së zbatimit të Projektit;

e) Mallrat e prokuruara nga Projekti për organizatat partnere duhet të dorëzohen dhe të merren nga autoritetet përgjegjëse me miratimin e SDC-së.

Neni 8
Pezullimi dhe përfundimi i marrëveshjes

a) Secila Palë do të ketë të drejtën ta ndërpresë këtë marrëveshje, duke dhënë njoftim me shkrim gjashtë muaj para përfundimit të saj.

b) Nëse secila Palë çmon se qëllimet e kësaj marrëveshjeje nuk mund të arrihen ose se Pala e dytë nuk i përmbush detyrimet e saj, pala tjetër do të ketë të drejtë të pezullojë ose të përfundojë këtë marrëveshje duke dhënë njoftim me shkrim tre muaj para. Pavarësisht nga çfarë është parashikuar më parë, secila Palë mund ta ndërpresë këtë marrëveshje me efekt të menjëhershëm në rast të shkeljes së konsiderueshme të marrëveshjes. Shkelja e konsiderueshme nënkupton shkelje serioze të një prej objektivave thelbësorë të kësaj marrëveshjeje.

c) Pezullimi dhe mundësia e rihyrjes në fuqi do t'i njoftohet menjëherë Palës tjetër në rrugë diplomatike dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë pas marrjes së informacionit nga Pala tjetër.

d) Nëse rastet që rezultojnë nga forca madhore pengojnë ekzekutimin e marrëveshjes, secila Palë mund ta ndërpresë marrëveshjen me efekt nga momenti kur bëhet e pamundur për ta zbatuar atë.

e) Në rast të ndërprerjes së parakohshme të kësaj marrëveshjeje ose në fund të Projektit, çdo fond i pashpenzuar i siguruar në kuadër të Projektit, do t'i kthehet SDC-së.

Neni 9
Ndryshimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo modifikim ose ndryshim i kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me pëlqimin e të dyja Palëve.

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje zgjidhen nëpërmjet negociatave në rrugë diplomatike ndërmjet Palëve.

Neni 10
Dispozita të përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, Palët nuk do të propozojnë as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as të tërthortë, përfitime të asnjë lloj natyre. Ato nuk do të pranojnë asnjë propozim të tillë. Çdo sjellje korruptive ose e paligjshme nënkupton shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe justifikon ndërprerjen e saj, si dhe/ose alternativën ndaj masave plotësuese korrigjuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11
Kohëzgjatja dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje mbulon periudhën deri më 28 shkurt 2021. Ajo do të hyjë në fuqi me njoftimin e fundit mes palëve për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.

Kjo marrëveshje është hartuar në tri kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Të dyja versionet e teksteve janë autentike dhe kanë të njëjtën vlerë. Në rast të mospërputhjeve të interpretimit, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Palët, me anë të kësaj marrëveshjeje, konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje të lidhur në Tiranë, më ....

Në emër të Qeverisë së Konfederatës Zvicerane:	Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë:	
Adrian Maître	**Ogerta Manastirliu**	**Evis Kushi**
AMBASADOR Ambasada e Zvicrës në Shqipëri	MINISTËR Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	MINISTËR Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

VENDIM
Nr. 51, datë 27.1.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 904, DATË 24.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, TË KATEGORIVE PRIORITARE, MASËS SË PËRFITIMIT, AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE DHE PROCEDURAVE PËR VLERËSIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA DISA PROGRAME TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 18, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 23 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"23. Marrëveshja paraprake dhe kontrata për kalimin e banesave/shtëpive individuale në pronësi të subjekteve përfituese të programeve të rindërtimit dhe/ose atyre në funksion të procesit të rindërtimit duhet të përmbajnë, të paktën, parashikimet e modeleve tip, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij. Kontrata duhet të shoqërohet me deklaratën noteriale të heqjes dorë, nga subjektet përfituese, nga çdo pretendim mbi të drejtat e pronësisë për banesën apo shtëpinë individuale të mëparshme, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë vendim ose në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të miratuar me ligjin nr. 97/2019, si kusht për përfitimin nga programet e procesit të rindërtimit. Regjistrimi i akteve kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në emër të përfituesit.".

2. Në pikën 25, pas emërtesës "... Enti Kombëtar i Banesave ..." shtohet "... Agjencia Shtetërore e Kadastrës ...".

3. Pas shtojcës "Ç", bashkëlidhur vendimit, shtohet shtojca "D", "Marrëveshje paraprake për kalimin e së drejtës së pronësisë" (model tip), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA "D"

MARRËVESHJE PARAPRAKE PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË (MODEL TIP)

Në_____,sot, më datë ___._____._____, përpara meje noterit publik _____, anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterëve, Tiranë, me NIPT: _____ dhe licencë profesionale nr. _____, me seli në adresën: rruga " _____", _____, u paraqitën personalisht palët, si me poshtë:

_____, me seli në adresën _____, përfaqësuar nga _____, në vijim, referuar si _____ *(subjekti që ka të drejtën e pronësisë, pala e parë)*

dhe

z./znj._____ , atësia _____, i/e datëlindjes _____, lindur në _____, dhe banues/e në _____, mbajtës/e i/e dokumentit të identifikimit ID me numër personal _____, madhor/e dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në vijim, referuar si _____ *(subjekti përfitues, pala e dytë).*

Baza ligjore: nenet 162, 163 e vijues të ligjit nr. 7850, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"; ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligji nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; akti normativ nr. 9, datë 16.12.2019,

"Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore".

Meqenëse ekzistojnë këto kushte paraprake:
(*Të plotësohen rast pas rasti*)
palët bien dakord të lidhin këtë marrëveshje "Marrëveshja", si më poshtë vijon:

Neni 1
Objekti dhe qëllimi i marrëveshjes

Objekt i kësaj marrëveshjeje është kalimi i të drejtave të pronësisë, pa kundërshpërblim, të pasurisë së paluajtshme, të llojit njësi individuale banimi/njësi banimi në ndërtesa (pallat) (në vijim referuar si "pasuria"), e cila do të ndërtohet në truallin ekzistues/në zonat e reja për zhvillim të detyruar, nga pala e parë, në favor të palës së dytë.

Zona ku do të ndërtohet pasuria do të jetë në njësinë administrative nr. _____, zona e _____, sipas vendimit nr._____, datë_____, të Këshillit të Ministrave, "_____ _____".

Struktura e njësisë së banimit, që do të kalohet në pronësi të palës së dytë, do të llogaritet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 2
Kalimi i titullit të pronësisë

2.1 Kjo marrëveshje nuk përbën aktin përfundimtar të fitimit të pronësisë.

Palët kanë rënë dakord që transferimi i titullit të pronësisë, për pronën objekt të kësaj marrëveshjeje, si dhe regjistrimi i titullit të pronësisë nga pala e parë, në favor dhe në emër të palës së dytë, do të realizohet me nënshkrimin e kontratës përfundimtare të kalimit të pronësisë, e cila do të lidhet nëpërmjet palëve me akt publik, dhe do të regjistrohet sipas rregullave pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vetëm pas nënshkrimit të të gjitha dokumenteve të nevojshme dhe plotësimit të kushteve të mëposhtme.

2.2 Pala e parë merr përsipër të mbulojë të gjitha detyrimet dhe kostot, në lidhje me shpenzimet noteriale dhe regjistrimin e kësaj marrëveshjeje pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të saj.

Neni 3
Deklarime dhe garanci të palëve

3.1 Pala e parë, deklaron dhe garanton palën e dytë për secilën prej çështjeve të mëposhtme:

i) merr përsipër që ndërtimin e pasurisë ta kryejë në përputhje me parimet e rindërtimit, sipas kushteve dhe teknikave që parandalojnë rreziqet e fatkeqësive natyrore në të ardhmen, bazuar në konceptin "rindërto më mirë";

ii) merr përsipër të dorëzojë pasurinë, sipas parimit "me çelësa në dorë", të gatshme për banim;

iii) do të përmbushë detyrimet dhe do të plotësojë kushtet e parashikuara në këtë marrëveshje;

iv) për aq kohë sa kjo marrëveshje do të jetë në fuqi, pasuria, objekt i kësaj marrëveshjeje, nuk mund t'i premtohet, t'i jepet në përdorim apo t'i shitet një pale të tretë;

v) pala e parë deklaron dhe siguron se ka autoritetin dhe miratimet e duhura për të nënshkruar, zbatuar dhe përmbushur dispozitat e kësaj marrëveshjeje;

vi) pala e parë merr përsipër dhe garanton palën e dytë se, përgjatë gjithë kohëzgjatjes që do të duhet për dorëzimin e pasurisë, sipas parimit "me çelësa në dorë", do t'i sigurojë subvencionin e pagesës së qirasë deri në momentin që kësaj pale t'i kalojë e drejta e pronësisë së pasurisë, në bazë të vlerave dhe kushteve të miratuara, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3.2 Pala e dytë deklaron dhe garanton palën e parë për secilën prej çështjeve të mëposhtme:

i) pala e dytë pranon kushtet në këtë marrëveshje dhe është plotësisht dakord që, në momentin e duhur dhe pas plotësimit të kushteve të vendosura sipas legjislacionit në fuqi, të nënshkruajë kontratën përfundimtare të kalimit të pronësisë së pasurisë, objekt i kësaj marrëveshjeje;

ii) kjo marrëveshje përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe të ekzekutueshëm për palën e dytë, e cila i ka të gjitha kompetencat të lidhë këtë marrëveshje dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj;

iii) pala e dytë do të nënshkruajë deklaratën noteriale për heqje dorë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

3.3 Nëse pala e dytë nuk plotëson të gjitha kushtet e vendosura në legjislacionin në fuqi, atëherë kjo marrëveshje nuk do të ketë fuqi ligjore dhe pala e parë zhvishet nga të gjitha detyrimet e ngarkuara në këtë aktmarrëveshje.

3.4 Palët pranojnë se deklarimet dhe garancitë e parashikuara në nenet më sipër janë kryer në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe me qëllim angazhimin e secilës prej tyre për të lidhur këtë marrëveshje, duke i konsideruar ato të vërteta dhe të mirëqena.

Neni 4

Legjislacioni i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

4.1 Kjo marrëveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

4.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen, direkt ose indirekt, ndërmjet palëve kontraktuese, lidhur me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje, palët paraprakisht duhet të diskutojnë për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet një marrëveshje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Unë, noteri, pas leximit të kësaj marrëveshjeje të përgatitur në 4 (katër) kopje në shqip, me zë të lartë, palëve, dhe pasi u sigurova se palët e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë, vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit shqiptar.

(Subjektipërfitues) (Subjekti që kalon të drejtat e pronësisë)

_____ _____

NOTER

VENDIM
Nr. 52, datë 27.1.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTIT TË NDËRHYRJEVE REHABILITUESE/PËRSHTATËSE TË NEVOJSHME PËR KTHIMIN E STRUKTURËS SË OBJEKTEVE QË JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME DËMTIME TË MËDHA STRUKTURORE OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA JOSTRUKTURORE, NË BASHKINË KRUJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 64 047 500 (gjashtëdhjetë e katër milionë e dyzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në Bashkinë Krujë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2021, dhe i transferohet, në formën e transfertës së pakushtëzuar, Bashkisë Krujë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 6, datë 19.1.2021

PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E KËRKESAVE SPECIFIKE PËR ARSIMIMIN E INSPEKTORËVE NË INSPEKTORATET SHTETËRORE/VENDORE DHE STRUKTURAT E TJERA INSPEKTUESE

Në zbatim të germës "f", të pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Inspektorati Qendror, miraton kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore.

Me qëllim formimin profesional të inspektorëve shtetërorë/vendorë për hartimin dhe miratimin e kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore, si dhe inspektorëve të strukturave të tjera përgjegjëse inspektuese;

URDHËROJ:

1. Hartimin e kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve shtetërorë/vendorë dhe strukturave të tjera përgjegjëse të inspektimit, sipas fushave të tyre inspektuese.

2. Përfaqësuesit e inspektorateve shtetërore/vendore, si dhe strukturat e tjera përgjegjëse inspektuese, duhet të hartojnë kërkesat specifike për arsimimin për çdo fushë inspektimi, duke bashkëpunuar me Inspektoratin Qendror.

3. Inspektorati Qendror, pas hartimit të kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve shtetërorë/vendorë, nga çdo inspektorat shtetëror/vendor apo strukturë përgjegjëse e inspektimit, bën miratimin e kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve dhe i publikon ato në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror, në adresën: www.insq.gov.al.

4. Ngarkohen Inspektorati Qendror, inspektoratet shtetërore/vendore, si dhe strukturat e tjera përgjegjëse për inspektimin, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari

VENDIM
Nr. 158, datë 30.12.2020

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME BELSH SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.12.2020 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Belsh sh.a.",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Belsh (UK Belsh) me shkresën nr. 112/1 prot., datë 3.12.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Belsh në konformitet me

kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Belsh ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 32 630 banorë të Bashkisë Belsh;

b) Drejtues teknik i shoqërisë z. Ndriçim Sinani është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega "Hidroteknikë", në vitin 1995, plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Belsh, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efiçencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Belsh është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore, të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Belsh sh.a., me (NUIS L63215202R), në kategoritë:

a) kategoria A – për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Belsh sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

a) drejtues ligjor: Endri Pepa;

b) drejtues teknik: Ndriçim Sinani.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Belsh sh.a. është Bashkia Belsh.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Belsh sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Belsh sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 159, datë 30.12.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 40, DATË 1.6.2018, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME TROPOJË"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.12.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 40, datë 1.06.2018 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tropojë (UK Tropojë), me shkresën nr. 104 prot., datë 28.9.2020, me lëndë "Dërgim dokumentacioni për ndryshimin e drejtuesit ligjorë dhe drejtuesit teknikë të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Tropojë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Tropojë për herë të fundit me vendimin nr. 40, datë 1.6.2018 "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë", me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Tropojë sh.a., z. Bajram Gjongecaj, ka mbaruar studimet e larta në Ekonomi, në vitin 1981, me titull "Ekonomist për industrinë".

5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Tropojë sh.a., z. Visard Byberi, ka mbaruar studimet e larta master profesional në "Inxhinieri Hidroteknike", në vitin 2018.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tropojë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Tropojë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. 40, datë 1.6.2018 "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë" bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor: Bajram Gjongecaj";

"Drejtues teknik: Visard Byberi".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 160, datë 30.12.2020

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME MALËSI E MADHE SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.12.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a.'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe (UK Malësi e Madhe), me shkresën nr. 1037 prot., datë 1.12.2020, si dhe plotësimet me

shkresë përcjellëse nr. 1300 prot., datë 14.12.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, të UK Malësi e Madhe, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Malësi e Madhe ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 31 071 banorë të Bashkisë Malësi e Madhe;

b) Drejtues teknik i shoqërisë, z. Adi Hasanaj, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega "Hidroteknikë" dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Malësi e Madhe, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Malësi e Madhe është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. me (NUIS: K48420718C), në kategoritë:

a) kategoria A - për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C - për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor – Ndoc Prela;

b) drejtues teknik – Adi Hasanaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. është Bashkia Malësi e Madhe.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5387, datë 11.12.2020, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Fatmir Skënderi, në datën 13.6.2008, i lindur më datë 6.12.1963, në Frashër, Përmet.

KËRKESË

Shtetasi Alket Shabani kërkon pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë shpalljen të zhdukur të shtetasit Naim Shabani, më datë 30.7.1997, lindur në Tragjas, më 15.3.1952, dhe banues në Orikum.

KËRKUES
Alket Shabani

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 16
Datë: 2021/02/02 15:39:12
06208051-d11d-4e8b-9cab-6d22f087b967

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 688 lekë